

ENDRIT MARKU

PAS SHPATULLAVE TË UDHËHEQËSIT

SEMIOTIKA E HAPESIRAVE TE PUSHTETIT GJATE FJALIMEVE TE KRIZES COVID-19

POLIS_PRESS

Tiranë, Janar 2021

Recensent : Prof. Dr. Ardian Ndreca
Recensent : Dr. Ledian Bregasi
Redaktor Shkencor: Dr. Elona Karafili
Redaktor Letrar: Arta Marku Qëndro
Faqosja: Steisi Vogli
Kopertina: “Realities” nga Dr. Endrit Marku

Botuar nga POLIS_PRESS, Njësia e Botimeve e Universitetit
POLIS

Kontakt:
Rr. “Bylis“ Nr. 12, Autostrada Tiranë - Durrës, Km.5, Kashar
Kodi Postar 1051, Kp 2995, Tirana, Albania
Tel: +355.(0)4 24074 - 20/21
Internet: www.universitetipolis.edu.al
E-mail: info@universitetipolis.edu.al

Shtypur nga Shtypshkronja Mediaprint

ISBN 978-9928-347-00-8



Përmbajtje

Prolog	6
Fjalimet e luftës	8
Nëpër Shkretëtirën e Reales	12
Donald Trump	16
Zyra Vezake	17
Familja e presidentit	22
Monedhat e sfidës	23
Zëvendësimi i skulpturave	25
Nuk do t’ju lemë mbrapa	27
Angela Merkel	32
Tone të ngrohta	33
Në kërkim të qendrës	35
Në kërkim të këndit më të mirë	41
Gjetja e vendit më të mirë	45
Në krye të qendrës së përbashkët	47

Aleksandar Vučić	54
I pari mes të barabartëve	55
Përtej pëlhurës	57
Pallati i ëndrrave	58
Dikotomia e hapësirës	61
Solidariteti mes kombeve është përrallë	64
Në gjurmët e Jugosllavisë	65
Edi Rama	68
Qerthulli komunikues	70
Një zanafillë e rezistencës për ekzistencë	72
Hapësira qëllimisht e pamenduar	75
Fshehja e automatizmave	80
Nëpër hiperrealitetet e udhëheqësit	81
Brenda surrealistit të tij	83
Simulakra e paraardhësit	87
Ismaili sipas nesh	90
Kujtesa si zëvendësuese e pritshmërisë	96
Albin Kurti	102
Thyerja e strukturës	103
Hapësirë kalimtare	106
Autenticiteti përsëri	107
Epilog	112
Bibliografi	118

*“Jetojmë në një botë që ka shumë e më shumë
informacion dhe pak e më pak kuptim”*

Jean Baudrillard

Prolog

29 mars 2020. Akrepat e orës lëvizën 60 minuta përpara. Pjesa më e madhe e botës e humbi orën e fituar 6 muaj më parë. Lajmi i ngjarjes së rëndësishme, që përsëritet në mënyrë sistematike e me devotshmëri të njëjtë, dy herë në vit, kësaj radhe kaloi pa u ndjerë. Këtë mars nuk na e rikujtuam se sa traumatik do të ishte ndryshimi i radhës për shëndetin tonë fizik e mendor, se si do të flinim më pak e do të zgjoheshim më nursëzë. Nuk na këshilluan të flinim më shumë apo të hanim më shëndetshëm e mbi të gjitha, askush s’na tha të bënim shëtitje të gjata nën rrezet e diellit por përkundrazi. Pasojat e mungesës së sivjetshme të këtij informacioni nuk do t’i dimë kurrë ndërsa vëmendjen tonë e ka

përfshirë një numër i pafundmë lajmesh të cilat kanë të njëjtin subjekt: Koronavirusin e ri.

Brenda pak ditësh përditshmëria jonë ndryshoi për fajin e një krijese mikroskopike po aq primitive sa vetë instinkti i mbijetesës që ndezi në thellësinë e qenies tonë. Ndërsa numëronim javët a muajt e karantinimit të detyruar, ngjarje rreth të cilave vërtiteshin miliona dollarë sikurse rrokullisja e një sferë prej gome dhe lëkure nëpër bar dhe përplasja e saj mbi një rrjetë najloni, këshillat e vyera mbi dhjetra mënyrat e lyerjes së vezëve të Pashkës apo vetë ora e humbur ose e fituar me datë 29 mars, u zhvlerësuan përballë epidemisë mbarëbotërore. Por, sado që u kyçëm brenda, një pjesë e mirë e marrëdhënieve të përditshmërisë tonë

rezistuan. Mes tyre marrëdhënia jonë me autoritetin dhe komunikimi i njëanshëm apo i ndërsjellë përmes realitetit digjital. Madje, këto marrëdhënie ekzistuese u bënë edhe më intensive. Marrëdhënia me autoritetin u bë më e afërt se kurrë, pasi nuk mund të dalësh dot nga shtëpia pa e pyetur, apo të rrish jashtë më shumë se disa orë, pa i dhënë llogari. Dikur shikonim parashikimet e motit ndërsa tani përditësojmë faqe pushtetarësh nëpër facebook për të ditur se çfarë do të na lejohet nesër. Nga ana tjetër mjedisi dixhital i imunizuar prej sulmeve të viruseve organike është në kulmin e tij, aty flasim me njerëzit e dashur, aty punojmë, aty informohemi e po aty takohemi, gjithnjë e më shpesh, me vetë përfaqësuesit më të lartë të autoritetit, siç janë udhëheqësit e shteteve.

Fjalimet e luftës

Gjatë muajit mars e në vazhdim kemi qenë dëshmitarë të një vale të njëpasnjëshme fjalimesh presidentësh, kancelarësh e kryeministrash shtetesh, secili rreth subjektit të sipërpërmendur: Koronavirusi i ri. Duket se bashkë me vetëdijen për rrezikshmërinë e virusit, është rritur dhe vetëdija e udhëheqësve se mbase në këto muaj do të shkruhen faqet më të ndritura të autobiografive të tyre. Komunikimet me publikun u bënë më solemne, me një gjuhë që e mendonim të humbur nëpër kthinat kohore më të dhunshme të së kaluarës tonë. Kështu në këtë hapësirë kohore, më

shumë se kurrë, përdoret fjala *luftë*. Me datë 18 mars kancelarja gjermane Angela Merkel i kujtonte popullit të saj se do të përballeshin me sfidën më të vështirë:

“që nga ribashkimi Gjerman, jo, që nga Lufta e Dytë Botërore” (Merkel, 2020)

Sikurse ajo, njëri pas tjetrit, udhëheqësit e të gjitha vendeve të prekura nga Koronavirusi i ri, e shënjuan me një fjalim drejtuar kombit, nisjen e përbaljes së drejtëpërdrejtë me epideminë. Dhe në fakt duhet të shkojmë në fillimet e konfliktit më të madh botëror të të gjitha kohërave për të dëgjuar kaq shumë fjalime të njëpasnjëshme, me të njëjtin solemnitet e të strukturuar në mënyrë të ngjashme. Dikur Churchill-i, pas disfatës së Dunkirk-ut, në qershor të 1940-ës, gjatë fjalimit të tij të famshëm *Their finest hour* (Churchill, 1940) i siguronte bashkëkombasit për pathyeshmërinë e flotës britanike, që njëkohësisht ishte muri i fundit që i ndante nga superfuqia ushtarake e Gjermanisë. Stalini në fjalimin e tij të 3 korrikut të një viti më vonë, plot njëmbëdhjetë ditë pas sulmit të rrufeshëm gjerman, i tregonte popullit sovjetik se si:

“trimëria e ushtarëve të ushtrisë së kuqe nuk kishte të dytë” (Stalin, 1941),

duke u munduar të gjente së paku diçka shpresëdhënëse të tiparet e ushtrisë së tij që deri atë ditë kishte korrur

vetëm humbje. Në pranverën e vitit 2020, rolin mbrojtës të ushtrive e ka marrë përsipër sistemi shëndetësor. Kështu kancelarja gjermane shpjegon se:

*“Gjermania ka një sistem shëndetësor të shkëlqyer, e mbase më të mirin në botë”
(Merkel, 2020)*

po ashtu presidenti Trump, i siguron amerikanët se:

“Ekipi ynë (i amerikanëve) është më i miri në të gjithë botën” (Trump, 2020).

E kështu paralelizmat janë të shumta, pasi të njëjtat mesazhe i rigjen të nënvizuara nëpër fjalimet e asokohe dhe të kësokohe. Popullit i jepet zemër duke e siguruar që rezistenca ndaj armikut po forcohet dita ditës, që armiku në fakt, në përballjen me ta, ka qenë më pak i suksesshëm se tjetërkund dhe që duhet të jemi të bashkuar, pasi fitorja doemos do të vijë.

Udhëheqësit e Luftës së Dytë flisnin përmes valëve të radios, me zë. Mesazhi i tyre i përcillej popullit nga radiot, në mjedise të mbyllura apo shtëpi si dhe përmes altoparlantëve të vendosur në sheshe. Mundohuni të përfytyroni fshatarët sovjetikë që dëgjojnë me ankth Stalinin, në oborrin e ndonjë ferme socialiste, disa ditë pas sulmit gjerman apo stërgjyshërit tanë, grumbulluar poshtë altoparlantëve, te ballkoni i Bashkisë së vjetër



Figura 1. Qytetarë të Tiranës, përpara Bashkisë së vjetër, dëgjojnë fjalimin e Duçes, gjatë të cilit ai i shpalli luftë Anglisë. 10 qershor 1940, (Instituti Luce)

të Tiranës, duke dëgjuar me kureshtje udhëheqësin e tyre të përkohshëm, Benito Musolinin, që i shpall luftë Anglisë (fig.1). Ata duhet të dëgjonin me vëmendje, duhet të kapnin kuptimet e fshehura përmes fjalëve dhe ndryshimet në intonacionin e folësve. Për fjalën e radhës do t'u duhej të prisnin ditë e mbase javë të tëra. Ata që jetonin në qendrat e mëdha do ta lexonin përsëri fjalimin të nesërmen, në gazetë, e më pas do të flisnin për të edhe një herë, në ndonjë kafene.

Sot shpërhapja e mesazheve është më komplekse. Ata na vijnë me zë dhe me figurë, me komente që bëhen në kohë reale, madje ende pa përfunduar

mesazhi. Dëgjuesit më shumë bëjnë sikur dëgjojnë pasi ndërkohë që udhëheqësi është ende duke folur, fillojnë të reagojnë. Nën videot e tyre drejtpërsëdrejti shfaqen vargje me ikona gishtpërpjeta, fytyrëqeshura, zemërkuqe apo faqeskuqura. Bashkë me to, fillojnë komentet e para, të cilat rriten me mijëra pas çdo rifreskimi të faqes. Disa shajnë, disa lavdërojnë, të tjerë shajnë ata që lavdërojnë derisa e tëra shndërrohet në një dallgë të rrëmbyer informacioni që mund të zgjasë me orë të tëra e që në të vërtetë nuk ndalet kurrë. Në vazhdim, mesazhi shpërndahet faqe pas faqeje, nëpër të cilat lajmi zberthehet, rindërtohet, i bashkëngjiten tituj të ndryshëm dhe shtesa interpretuese. Dhe një herë lajmi bëhet gati për t'u rishpërndarë sipas audiencave të posaçme. Sot, më shpejt se asnjëherë, mesazhet shpërbëhen e shumëfishohen duke humbur vetë lidhjen me mesazhin origjinal dhe bëhen pjesë e asaj që Baudrillard e quan, *Shkretëtira e Reales* (Baudrillard, 1994).

Nëpër Shkretëtirën e Reales

Nëpër këtë shkretëtirë, që më shumë se me një ultësirë ranore të zbrazur, ngjan me një luginë me gjembaçë, udhëheqësit botërorë u drejtohen njëri pas tjetrit qytetarëve të tyre, para kameras, brenda një hapësire, me paraqitjen e tyre domethënëse. Por në ditët e pandemisë diçka ndryshon. Momenti është aq solemn, sa mesazhet e kanë shansin që ta përshkojnë tejprërtej

shkretëtirën. Pandemia është *lufta* thonë ata, e lufta nënkupton edhe *vdekjen*. Platoni te *Republika* shpjegon se vetë:

“...qyteti u krijua pasi individi nuk është
i vetëmjaftueshëm dhe ka shumë nevoja”
(Plato, 1997)

ndërsa Rudolf Arnheim shton se *rendi është parakusht i mbijetesës* (Arnheim, 1974). Pra në ditët e pandemisë, teksa ndihemi edhe më të vegjël e të pafuqishëm se zakonisht, i kthejmë sytë nga autoriteti, nga drejtuesit e rendit tonë. Meqenëse ekzistenca jonë është e rrezikuar kërkojmë më shumë rregulla dhe pranojmë të heqim dorë nga liritë tona. “*Rezistencë për ekzistencë*” thotë kryeministri i Shqipërisë dhe ne biem dakort, e kush nuk do që të ekzistojë. Nën pandemi drejtuesit e shteteve po ngjisin kurbat e popullaritetit, duke ekplisuar vetë kurbën famëkeqe të infektimeve. Populli i do më shumë, u beson më tepër dhe është gati t’u falë dhe ndonjë mëkat të kaluar. Përmbi shkretëtirën e reales Koronavirusi i ri ka ndërtuar për ta autostrada. Më poshtë do kalojmë nëpër fjalimet e mbajtura nga disa krerë shtetesh, përgjatë ditëve më të vështira të fillimeve të pandemisë. Mes morive të fjalëve publike, që ata rëndom kanë shpërndarë gjatë këtyre muajve, do të shkëpusim vetëm disa, ato më solemnet që janë shkruar dhe vënë në skenë më me kujdes. Do përqendrohemi te mesazhet që shënuan fillimin e të ashtuquajturës

betejë. Së bashku do të përpiqemi t'i lexojmë sipas një këndvështrimi tjetër, pasi do të përqendrohemi tek aspekti që i dallon ato më së shumti nga fjalët e paraardhësve të messhekullit të XX. Mes zërit dhe figurës ne do të shqyrtojmë të dytën. Nuk do merremi vetëm me atë që thonë përmes fjalëve por edhe me çfarë na thonë përmes hapësirave ku ata ndodhen. Në vazhdim do të këqyrim elementet që rrethojnë folësit, mënyrën se si ata qëndrojnë përballë nesh, e mbi të gjitha si komunikojnë përmes sfondeve të tyre. Së bashku do të ndërmarim një rrugëtim kundër rrymës, duke e nisur nga ne, vrojtuesit, do të shkojmë tek ata, dërguesit. Do të sillemi nëpër zyrat e tyre, do shohim si i kanë përgatitur për rastin, pse e kanë zgjedhur një hapësirë të caktuar dhe pse e kanë organizuar ashtu. Do shkojmë sa më në thellësi nëpër një udhëtim në hapësirë dhe kohë, brenda dhe përtej planit të kamerës. Do e nisim nga zyra vezake e presidentit Trump, do të vazhdojmë me këndin pranë dritares së kancelarisë gjermane të zgjedhur nga Angela Merkel, me sfondin mbretëror të presidentit serb, me sfondin çuditërisht të varfër të kryeministrit shqiptar dhe me hapësirën kalimtare të kryeministrit të Kosovës. Le të zëmë një qoshe në *universin e simuluar* (Baudrillard, 1994), brenda të cilit tashmë jetojmë, për të kërkuar sa më shumë kuptim. Sipas Arnheim (Arnheim, 1988) drejtimi vertikal i imazhit është dominuesi, dhe njihet si dimension i soditjes, *contemplation*. Figuratat që vendosen në këtë drejtim janë më të rëndësishmet

dhe janë aty për të na vënë në mendime. Në rastet tona do të shohim që kjo hapësirë u përket folësve. Dimensioni tjetër, ai horizontal, njihet si hapësira e veprimit, *activity*. Nëpër këtë hapësirë shtjellohet narrativa e ngjarjes. Vështrimi ynë do kalojë nëpër këto drejtime, do të mundohemi të kuptojmë si ndërthuren ato dhe si përputhet gjuha e folur me gjuhën pamore.

Donald Trump

Presidenti Amerikan qëndron përballë nesh i ulur në tavolinën e tij të punës, në zyrën vezake (oval) (fig.3). Vendndodhja mjafton për të kuptuar rëndësinë e mesazhit, pasi kjo tryezë me murin e harkuar të zyrës presidenciale në sfond, është pozicioni më i shpeshtë prej ku presidentët kanë ndarë, me amerikanët dhe botën, lajme dhe vendime vërtet të rëndësishme (fig.2). Këtu Eisenhower mbante fjalimin e lamtumirës, Kennedy fliste për krizën e murit të Berlinit, Lyndon Johnson e Richard Nickson-i për zhvillimet e luftës së Vietnamit. Po nga kjo zyrë dhe ky sfond, Gerald Ford-i do ta falte Nickson-in pas skandalit Watergate-it. Në vazhdim nga kjo hapësirë, Carter-i, do të informonte

për krizën e pengjeve në Iran, Regan-i për aksidentin e anijes kozmike Challenger, George Bush-i për luftën në Irak, Clinton-i për Kosovën dhe bombardimin e Jugosllavisë, George Bush Jr për sulmet e 11 shtatorit dhe Barak Obama për masakrën e San Bernardinos. Donald Trump-i vazhdon, sipas traditës së paraardhësve, skena dhe skenari janë të ngjashëm, ndërsa veçantitë e mesazhit të tij do të na duhet t'i kërkojmë nëpër detaje.

Zyra Vezake

Formatin e sotëm televiziv të fjalimit presidencial e gjejmë të paktën që nga presidenti Eisenhower (fig. 2/a). Kreu i shtetit rri në qendër dhe përballë kamerës, kryesisht ulur, i mbështetur mbi tavolinën



Figura 2. Nga e majta në të djathtë dhe nga lart poshtë paraqiten presidentët amerikanë; a: Eisenhower; b: Kennedy; c: Johnson; d: Nickson; e: Ford; f: Carter; g: Reagan; h: Bush; i: Clinton; j: Bush Jr; k: Obama duke mbajtur fjalimet e tyre në zyrën vezake. (youtube)







Figura 3. Presidenti Amerikan gjatë fjalimit të 11 marsit, mbi krizën koronavirus. (youtube)

e tij. Shumica e presidentëve që nga vitit 1880, përfshirë Donald Trump-in, kanë përdorur tavolinën “Resolute” (Association, n.d.), “e Patundura”, dhuruar nga mbretëresha Viktoria, bërë me drurin e lisit të anijes angleze me të njëjtin emër e cila u braktis gjatë një ekspedite shpëtimi mes akujve të arktikut dhe iu rikthye më vonë anglezëve nga amerikanët. Tryeza është shpesh e zbratur megjithëse në fjalime të caktuara gjejmë dhe ndonjë objekt. Për shembull telefonin e bardhë dhe modern (për kohën) te zyra e Kennedy-t dhe e Nickson-it (fig. 2/b/d), a thua se po i siguronin qytetarët e tyre se ishin vigjilentë e të përditësuar për çdo ndodhi të rëndësishme për fatet e vendit, ose dy dosjet në krah të presidentit Bush jr, gjatë fjalës së tij pas sulmeve të 11 shtatorit (fig. 2/j),




Figura 4. Elementët që e rrethojnë presidentin gjatë fjalës së tij. a: dosja; b: dritarja; c: tre fotografitë e përzgjedhura; d: monedhat e sfidës dhe modeli i vogël i shtëpisë së bardhë; e: modeli i vogël i skulpturës me dy ushtarët. Me 1 dhe 2 janë shënuar dy boshtet e imazhit, boshti vertikal ose i soditjes dhe boshti horizontal ose i veprimit.

mbase për të treguar se tashmë ai zotëronte të vërtetën. Edhe në tavolinën e presidentit Trump ka një dosje (fig. 4/a). Koronavirusi i ri është sheshit, po mbjell vdekje edhe në Amerikë. Shkretëtira e reales është aq e mbipopulluar nga informacioni sa që amerikanët nuk dinë kujt t'i besojnë, atyre u duhet *dija* e presidentit. Sot më shumë se asnjëherë ai duhet të tregojë që i ka bërë detyrat e shtëpisë.

Një veçanti e zyrës vezake është dritarja e gjithnjëgjendur pas krahëve të udhëheqësit (fig. 4/b). Në fakt janë tre të tilla, të njëpasnjëshme, përgjatë murit absidal të fasadës jugore të Krahut Perëndimor (West Wing) të Shtëpisë së Bardhë. Ndërsa sot, transparenca është një mjet që

përdoret rëndom nga politikanët për të përcjellë idenë e hapjes përpara publikut, pak a shumë siç përdoren kolonat e larta e mermeret, për të përcjellë idenë e shtresëzimit dhe plotfuqisë, në kohën e konceptimit të zyrës (1909) kjo do ketë qenë risi. Kur presidenti amerikan i drejtohet popullit, - kjo vihet re sidomos ditën - shpina e tij është e “zbuluar”, pas tij duken pemët e kopshteve presidenciale dhe qielli të cilët vazhdojnë të pandërprerë përtej Bulevardit Kombëtar (National Mall) dhe Lumit Potomak. Presidentët amerikanë e kanë traditë t’i mbajnë perdet hapur, të paktën që nga fjalimi i vitit 1974 kur Gerald Ford-i (fig. 2) falte paraardhësin e tij fsheharak, Richard Nickson-in. Donald Trump-i flet gjithashtu para xhamit të zbuluar. Ai, si paraardhësit e tij, nuk mund t’ia lejojë vetes mbulimin e dritares, pasi zyrtarisht kryeson një shoqëri të hapur që nuk ia ka frikën askujt.

Përveç perdeve të arta, tipar dallues, i bizneseve Trump, detaje të tjera të përsëritura të sfondit janë dy flamurët, i Amerikës dhe i presidentit që shenjon praninë e tij kudo ku shkon, dhe tavolina e ngushtë nën dritare. Te kjo e fundit, më konkretisht te mënyra se si presidenti e ka stolisur, mund të gjejmë hollësitë vetjake të folësit dhe të mesazhit që dëshiron të përcjellë.

Familja e presidentit

Tavolina nën dritare ndryshon vazhdimisht sipas presidentëve, aty gjen fotografi familjare, skulptura ish

presidentësh, figurash historike e plot elementë të tjerë. Fotografitë që mban Donald Trump kanë ndryshuar gjatë kohës. Në fillimet e presidencës, mbante vetëm fotografinë e babait, më pas shtoi edhe të nënës, të dyja bardhezi. Gjatë fjalimit për murin kufitar me Meksikën, do të shtonte dhe fotografinë e tij me zonjën e parë dhe të birin, këtë herë me ngjyra. Kështu tavolina është mbushur pak nga pak me të gjithë pjesëtarët e familjes. Pavarësisht këtyre shtesave, në fjalimin e Koronavirusit të ri, majtas mbizotërojnë vetëm tre fotografi (fig. 4/c), dy të përhershmet, bardhezi, të prindërve, që duken si shenjë krenarie e presidentit për rrënjët e ku mbase gjen edhe arsyet e suksesit personal, dhe një fotografi e tretë, artificialisht¹ bardhezi, ku ai ka pozuar me të bijën, Ivanka, kur kjo ishte ende fëmijë. Pra, ajo është trashëgimtarja më e denjë e të atit dhe e cilësive më të mira të familjes Trump. Ë majta e presidentit amerikan, babai, nëna, ai vetë dhe e bija, një person publik mjaft aktiv, po i tregon amerikanëve se Trump-ët janë të suksesshëm, dhe të tillë do jenë edhe në këto ditë të vështira.

Monedhat e sfidës

Krahu i djathtë i udhëheqësit dhe drejtimi më i rëndësishëm është edhe më i pasur me detaje. Elementët e parë të dukshëm janë disa radhë medaljesh mbi të cilat qëndron një model i vogël i Shtëpisë së bardhë

1 Fotografia është kopje e origjinalit me ngjyra.

(fig. 4/d), i origjinale pa shtesat e mëvonshme lindore dhe perëndimore. Medaljet janë monedhat e sfidës (challenge coin), një traditë e vjetër e ushtrisë amerikane. Ato përgatiteshin nga vetë ushtarët dhe përfaqësonin njësitë e tyre të luftës. Ato janë shenjë e forcës, e fitoreve dhe e vëllazërisë mes ushtarakëve që luftojnë krah për krah, për njëri-tjetrin dhe për atdheun. Presidenti Klinton ishte një koleksionues i monedhave dhe i mbante në sfond (fig. 2/i) njësoj si presidenti Trump (Vogel, 2018). Tradita e nisur nga Klinton-i tashmë ka zënë vend, madje tani presidentët amerikanë lëshojnë vetë monedha presidenciale. Trump-i është veçanërisht i lidhur me to dhe ka lëshuar shumë syresh, jo zyrtare, të cilat përkujtojnë ngjarje e vende të shënuara sipas tij. Me monedhat, që me sa kuptohet ia kanë dhuruar gjatë takimeve, ai u thotë amerikanëve, sidomos atyre në vijë të parë, që presidentin e kanë në krah. Ndërsa Klinton-i i mbante monedhat në radhë të mbivendosura pa ndonjë hierarki të dukshme, Trump-i zgjedh t'i vendosë ato poshtë maketit të




Figura 5. Mënyra e vendosjes së monedhave të sfidës mbi mobilje. a: organizimi i presidentit Trump; b: organizimi i presidentit Clinton.

Shtëpisë së bardhë (Fig. 5), pra medaljet janë në themel të kompozimit. Presidenti, gjithashtu po u thotë amerikanëve që ai vetë, Amerika nuk do të ishte dot pa ta.

Zëvendësimi i skulpturave

Qëndrojmë në të djathtë. Elementi i tjetër që kërkon vëmendjen tonë është një skulpturë e vogël që ka si personazhe dy ushtarë (fig. 4/e). Në fotot më të hershme të aktiviteteve të presidencës, Trump-i mbante një tjetër skulpturë pas krahëve: modelin e zvogëluar të shtatores mbi kalë të presidentit të shtatë amerikan, Andrew Jackson (fig.6/c). Origjinali i veprës ndodhet në qendër të kopshteve *Lafayette* përballë Shtëpisë së bardhë (fig. 6/b). Jackson-i ishte i burgosur nga anglezët, hero i betejës së New Orleans-it gjithashtu kundër anglezëve, pushtuesi i Floridës pas përballjes me spanjollët (Goode, 2010). Ai mbahet mend si udhëheqës i ashpër dhe, sipas New York Times, si i pari president populist i Amerikës (Haberma, 2017).

Përtej meritave dhe statusit të heroit, ai sot është figurë e diskutueshme. Konsiderohet përgjegjësi i të ashtuquajturit *shteg i lotëve*², ngjarje që shkaktoi mijëra viktima mes popullsisë native-amerikane (Pauls, 2019), të cilët u deportuan larg tokave të tyre stërgjyshore.

2 *Trail of tears*



Figura 6. Statuja mbi kalë e presidentit Jackson. a: Foto e Trump-it, bërë gjatë fjalimit për masat kundër Koronavirusit të ri. Pas tij mungon modeli i zvogëluar i statujës së Jackson-it (The Guardian); b: Memoriali i Jackson-it, i fotografuar mes 1900-1910-ës, në parkun Lafayette (Libraria e Kongresit); c: Foto e Trump-it, shkrepur gjatë një takimi në zyrën vezake, më 29 gusht 2019, ku duket modeli pas shpatullave të presidentit (Foto zyrtare e Shtëpisë së bardhë nga Shealah Craighead)

Ish presidenti, i admiruar nga presidenti i sotëm (Haberma, 2017), e që ndiqte fjalë për fjalë parimin “Amerika e para”, nuk duket asgjekundi brenda planit të kameras së 11 marsit (fig.6/a).

Andrew Jackson nuk ndodhet pas Donald Trump-it ditën e fjalimit mbi rrezikun Koronavirus. Vendin e tij e kanë zënë dy ushtarët. Këshilltarët e imazhit duhet ta kenë paralajmëruar udhëheqësin mbi dritë-hijet e paraardhësit të cilat nuk do ta ndihmonin në përcjelljen e mesazhit kryesor të fjalimit të tij:

*“Ne duhet ta lemë mënjane politikën, të ndalojmë dasitë partiake, dhe të bëhemi bashkë si një komb dhe një familje”
(Trump, 2020)*

Nuk do t’ju lemë mbrapa

Shtatorja e dy ushtarëve është varianti tripërmator i logos së organizatës jofitimprurëse, *Wounded Warrior Project* (Projekti i Luftëtarit të Plagosur). Shoqata ndihmon ish ushtarakët amerikanë, që janë dëmtuar duke i shërbyer vendit, nëpër procesin e vështirë të rehabilitimit dhe integritimit në shoqëri si civilë. Shtatorja iu dhurua presidentit, më 18 prill të 2019-ës, gjatë një takimi në Shtëpinë e bardhë, nga veteranët dhe përfaqësuesit e organizatës.

Skulptura paraqet një ushtar amerikan që mban mbi



Figure 7. Shtatorja e dy ushtarëve. a: Presidenti amerikan gjatë takimit të datës 18 prill 2019 kur iu dorëzua statuja e vogël që e mban vazhdimisht mbi tryezën pas shpinës (Associated Press nga Andrew Harnik); b: Skenë nga komedia “Forrest Gump”, 1994; c: Skenë nga filmi “I Lindur me 4 Korrik”, 1989; d: Poster i filmit “Kreshta Hacksaw”, 2016.

supe shokun e tij të plagosur rëndë. Ai nuk e lëshon atë, pavarësisht vështirësisë dhe mbase irracionalitetit të aktit, që vë dy jetë në rrezik. Skena në këndin e majtë të ekranit shpjegon një nga besimet e hershme të ushtrive amerikane, e cila shprehet shumë qartë në një frazë të filmit *We were soldiers* (Ne ishim ushtarë), i bazuar në ngjarjet e një prej betejave të luftës së Vietnamit:

*“Nuk do të lë asnjërin pas. Gjallë a vdekur,
ne të gjithë do të kthehemi në shtëpi së
bashku...” (Trump, 2020)*

Ky besim është tashmë pjesë e kulturës pop amerikane, e glorifikuar shpeshherë si subjekt filmash hollivudianë, madje të zhanreve të ndryshme (fig. 7). Në përgjithësi nëpër fushëbetejat e simuluar të kinematografisë amerikane ripërsëritet scena e ushtarit të plagosur që e tërheqin ose e marrin në krahë shokët. Kujtojmë këtu skenën e shpëtimit të marinsit Ron, të plagosur rëndë, të filmi *Born on the Fourth of July* (I lindur më 4 Korrik) apo filma si *Saving Private Ryan* (*Shpëtoni Ushtarin Ryan*) dhe *Hacksaw Ridge* (Kreshta Hacksaw) të strukturuar tërësisht rreth temës së shpëtimit të bashkëluftëtarit. Në një nga skenat e *Forrest Gump*, këtë herë një komedi, heroit në përpjekje për të gjetur shokun e tij të plagosur, bën disa herë vajtje ardhje nëpër xhungël duke shpëtuar këdo që i del përpara, madje ai merr në krahë dhe komandantin e tij që kishte humbur këmbët dhe që i përgjerohej që ta linte të vdiste



Figure 8. Pastori Harry Jackson duke mbajtur lutjen e Pashkës drejtpërdrejt nga zyra vezake. Me rreth është shënuar shtatorja e ish presidentit Jackson që mungonte ditën e fjalimit për krizën nga Koronavirusi i ri (C-SPAN)

në fushëbetejë. Pra mesazhi i statujës së vogël është i thjeshtë dhe i menjëhershëm dhe prek ndjeshmëritë e të gjithë amerikanëve.

Me simulakrat ushtarake në të djathtë të tij presidenti po i përgatit amerikanët për luftën e radhës. Amerika di t’i fitojë ato por e di po aq mirë që beteja pa viktima nuk ka. Ndërkohë ajo që ka rëndësi është:

“Të sillemi me dhembshuri dhe dashuri, të shërojmë të sëmurët, të kujdesemi për ata në nevojë, të ndihmojmë bashkëqytetarët tanë dhe të dalim nga kjo sfidë më të fortë dhe të bashkuar se kurrë” (Trump, 2020)

Thirrja e presidentit amerikan është paqtuese. Por shpejt kjo frymë do të ndryshojë, kriza Koronavirus do të thellohet dhe fryma e mirëkuptimit mes tij dhe palëve të tjera politike do të zbehet. Për Pashkë, Trump-i shfaqet përsëri prej zyrës vezake e ndërsa krah tij pastori Harry Jackson mban lutjen e festës (fig. 8), pas shpine rishfaqet skulptura e ish presidentit luftarak Andrew Jackson.

Angela Merkel

E thjeshtë dhe e përmbajtur (fig. 9), udhëheqësja gjermane flet me lëvizje minimale të trupit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së fjalimit. Për seriozitetin e mesazhit na paralajmëron skena e pazakontë dhe sfondi i saj, që zhvillohet më së shumti jashtë hapësirës së kontrolluar të dhomës. Qyteti përtej xhamit duket i heshtur, a thua se kemi të bëjmë me një fragment kohe të ngrirë. Asgjë nuk pipëtin ndërsa vëmendjen e marrin fytyra e kancelares, dhe tingujt e qetë që dalin prej buzëve të saj. Ajo qëndron e mbështetur mbi bazën horizontale të tavolinës së drunjte, e cila duke qenë se e mbyll plotësisht pjesën e poshtme të imazhit, i jep qëndrueshmëri gravitacionale strukturës së kompozimit dhe sidomos siluetës trapezoidale të kancelares.

Tone të ngrohta

Angela Merkel ka veshur kostum blu. Ngjyra e përzgjedhur e njëson atë me atmosferën e përgjithshme të dhomës dhe peizazhit, me qiellin e kaltër, çatitë reflektuese të ndërtesave, muret dritëpërthithëse prej betoni të interierit dhe flamurin e Europës. Veshja e zgjedhur nga Angela Merkel duket sikur ka ndjekur, fjalë për fjalë, sugjerimet nga *Pantone*, firmë me ndikim në përcaktimin e tendencave të ngjyrave në tregun e dizajnit. Në faqen e tyre e nëpër mediat sociale ata na kujtojnë herë pas here, se bluja klasike (classic-blue) është ngjyra e vitit 2020 dhe sqarojnë tekstualisht se ajo:

“...përçon qetësi, vetëbesim, afërsi me të tjerët, dëshirë për të ngritur themele



Figura 9. Fotografi e shkrepur gjatë fjalimit të kancelares gjermane të mbajtur me datë 18 mars, mbi pandeminë koronavirus, (DPA nga Steffen Kugler)

*të besueshme dhe të qëndrueshme mbi
të cilat mund të ndërtojmë, ndërsa së
bashku kapërcejmë pragun e një ere të
re” (Pantone, 2020)*

Forma e udhëheqëses lundron nëpër kaltërsinë e përgjithshme të mjedisit, e shkrirë mes toneve më të ftohta, të cilat shtrihen në pjesën më të madhe planit (fig. 10/a). Arnheim e përshkruan forcën shprehëse të ngjyrës por dhe vështirësinë për t’ia zbërthyer kuptimet (Arnheim, 1954). Ai na tregon se si në gjuhën pamore ngjyrat ndahen sipas toneve: të ngrohta dhe të ftohta. Pra, me një gjuhë krahasuese të huazuar nga perceptimi i temperaturës mbi lëkurën tonë, i të ftohtit dhe të ngrohtit. Pikërisht te kjo afërsi e të përshkruarit të dy ndjesive, megjithëse të perceptuara përmes shqisave

të ndryshme, Arnheim na jep një prej mundësive të interpretimit të toneve në gjuhën pamore:

“Një njeri i ftohtë na shtyn të mbyllemi brenda vetes. Ne ndjejmë se duhet të mbrohemi nga një pushtet i dëmshtëm – kështu ndrydhemi dhe mbyllim portat. Një njeri i ngrohtë na shtyn drejt hapjes. Ai na tërbeq dhe me dëshirë duam t’i tregojmë atij çdo gjë që kemi” (Arnheim, 1954)

Paleta e ngjyrave të hapësirës së fjalimit mund të ketë një ndikim të ngjashëm dhe te ne. Sipas piktorit ekspresionist dhe pedagogut të Bauhauss-it, Johanes Itten, dy ngjyrat skajore që përcjellin këto ndjesi, janë *e kuqe - portokalli* dhe *blu - e gjelbër* (Arnheim, 1954).

Pasi bëjmë përzgjedhjen e toneve të imazhit përmes të kuqes (fig. 10/b) zbulojmë që zonat më të ngrohta të tij pra edhe pjesët më të hapura dhe ftuese janë flamuri i Gjermanisë, pjesët e zbuluara të trupit të kancelares dhe ndërtesa e parlamentit gjerman në sfond. Këto elemente dhe tonet më të ngrohta në përgjithësi, megjithëse zenë sipërfaqe më të vogël, janë dominuese, pra e kërkojnë me më shumë forcë shikimin e vrojtuesit.

Në kërkim të qendrës

Shpërbërja e imazhit sipas toneve kryesore, na lejon të identifikojmë një sërë elementesh mbizotërues




Figura 10. Analizë e toneve të imazhit. a: grafik i shpërdarjes së toneve të imazhit mes blusë dominuese (në pjesën e poshtme) dhe të kuqes më pak të shtrirë (në pjesën e sipërme); b: pjesët më të ngrohta të imazhit të fjalimit, flamuri gjerman, fytyra, duart dhe Reichstag-u.

të cilët i lidhte së bashku ngrohtësia e tyre. Tani le të afrohemi më shumë duke i zbërthyer figurat në ekran sipas njësave themelore të gjuhës pamore, pra sipas *rajoneve topologjike të grupuara në fusha forcash* (Qëndro, 2011). Kjo përpjekje do të na ndihmojë të përcaktojmë marrëdhënien hierarkike mes elementeve të sipërpërmendur, duke na mundësuar identifikimin e mëtejshëm të pjesëve më kryesore.

Siç thamë më lart, elementët përbërës të skenës së fjalimit, tavolina, flamujt, muret, qielli, tarracat dhe vetë veshja, duket sikur po imitojnë qetësinë e përçarur nga kancelarja. Ato kanë sipërfaqe të lëmuara, krijojnë pak zhurmë dhe nuk kanë silueta dramatike. Flamujt e derdhur, qielli pa re apo kostumi i ngrirë flasin me tërësinë e formave dhe kryesisht me tonet e tyre. E megjithatë në disa nga rajonet e imazhit ky rregull nuk qëndron, nëpër këto zona mund të gjejmë dhe



Figura 11. Rajonet topologjike kryesore të imazhit

*kolorem*³ kryesore dhe njëkohësisht qendërsitë më të spikatura të tij (fig. 11). Nga një vëzhgim më i kujdesshëm dallojmë që duart, koka e kancelares, si dhe ndërtesa e Reichstag-ut zhvillohen njëra pas tjetrës, sipas boshtit vertikal të imazhit por dhe sipas diagonales që ndjek vatrën e perspektivës. Ato jo vetëm që ndodhen brenda bashkësisë mbizotëruese të toneve të ngrohta por zënë dhe rajonin më qendror brenda planit. Rëndësia e tyre, përveçse menjëherë e dukshme, del në pah edhe falë disa tipareve që janë tipike vetëm për to.

Tipari i kryesor dallues dhe përbashkues i duarve të kryqëzuara, i fytyrës së folëses dhe i fasadës së parlamentit është *simetria* (fig. 12). Ato janë të vetmet

³ Sipas përkufizimit të dhënë nga Gëzim Qëndro te "Gjuha pamore": "njësia bazë e gjuhës pamore njihet me termin koloremë. Ajo përkon me grumbullin e variablave pamorë të perceptuara në një paraqitje pamore me anë të fiksimit okular, apo fokusit të vështrimit." (Qëndro, 2011)




Figura 12. Elementet simetrikë të imazhit dhe boshtet apo planet e simetrisë përkatëse të secilit.

figura simetrike në hapësirën e fjalimit. Kjo veti e tyre bëhet dhe më e rëndësishme në këtë rast kur vetë imazhi i përgjithshëm nuk ka një kompozim simetrik. Kjo i bën ato, elementët më të qëndrueshëm brenda një kompozimi relativisht dinamik. Për të kuptuar situatën e krijuar mund të na ndihmojë përsëri një përkufizim i Arnheim-it:

“Simetria krijon qendërsi... ajo mund të jetë një fytyrë me boshtin e saj vertikal dhe me dy sytë, një figurë ballore me gjymtyrët simetrike ose fasada e një ndërtese” (Arnheim, 1988)

Arnheim gjithashtu shton se, qendra shpërhapet së bashku me simetrinë, dhe kështu silueta simetrike e




Figura 13. Disa nga boshtet e imazhit; a: mesorja që kalon te duart dhe e ndan imazhin në dy pjesë të barabarta; b: diagonale që ndjek vijën e perspektivës dhe bashkon kancelaren me ndërtesën e parlamentit; c: koka e kancelares dhe kubeja kanë të njëjtën madhësi dhe lartësi ndërsa hierarkia më e lartë i takon folëses falë pozicionit më qëndror dhe faktit që është figurë ndërsa parlamenti sfond.

trupit të Merkel-it shtrihet drejt ndërtesës në sfond dhe bashkohet me të. Në këtë rast krahët simetrike të Reichstag-ut shpalosen si flatra pas shpatullave të udhëheqëses.

Trupi i Angela Merkel-it nuk qëndron plotësisht përballë nesh, përveç fytyrës së saj, edhe boshti i simetrisë së imazhit nuk i kalon mes për mes, si në rastin e presidentit amerikan. Mesorja gjeometrike e planit kalon diku te duart e saj (fig 13/a). Po këtu, te rajoni i duarve, mesorja kryqëzohet me vektorët diagonalë të perspektivës (fig 13/b) të cilët vazhdojnë drejt thellësisë duke ndërtuar lidhje me sfondin. Pra, kancelaren dhe Reichstag-un nuk i lidh vetëm ngjashmëria në distancë



Figura 14. Pjesët e imazhit me forma të mirëpërcaktuara dhe teksturat më të pasura.

përmes simetrisë por edhe perspektiva e përbashkët. Dinamika e lindur krijon një marrëdhënie të përafërt me të ashtuquajturin, *parimi i fatit të përbashkët*, ose:

“dukuria pamore sipas së cilës elementët që lëvizin së bashku në mënyrë të njëtrajtsbme e ruajnë këtë cilësi njëlloj edhe kur janë të palëvizshëm” (Qëndro, 2011)

Parlamenti dhe kancelarja, kështu siç janë kompozuar (fig. 13), kanë të njëjtët vektorë, të njëjtin drejtim, të dy po ecin nëpër të njëjtën udhë dhe kanë të njëjtin destinacion. Ata duken si të ngrirë përkohësisht vetëm për kohëzgjatjen e fjalimit, të pandemisë mbase, për të vazhduar më pas udhën e përbashkët.

Tipare të tjera që i nxjerrin edhe më në pah tre elementët janë *format* e tyre të mbyllura e të konturuar qartë si dhe *tekstura* e pasur me detaje (fig 14), krejt ndryshe nga sipërfaqet e lëmuara të pjesëve të tjera. Pasuria e teksturës ndihet nëpër hijet e thella qofshin ato mes gishtave të duarve apo mes kolonave të fasadës së parlamentit, te rrudhat e fytyrës apo dhe te kontrasti i krijuar nga sytë e kaltër të Angela Merkel-it. E natyrisht mes fasadës së parlamentit që qëndron më i zbehtë në sfond, duarve dhe fytyrës dy të fundit janë protagonistët e imazhit.


Për një kancelare që ka famën e një udhëheqësi punëtor dhe që njihet për përdorimin e suksesshëm të mendjes, përqendrimi i vëmendjes te këto dy rajone topologjike duket mëse i natyrshëm.

E ndërsa rëndësia e pranisë fizike të kancelares, e shikimit të saj apo dhe e duarve të bashkuara ishte vetvetiu e dukshme, ja vlen kërkojmë pak më shumë për rëndësinë e Reichstag-ut, parlamentit gjerman i cili ashtu i larë nga rrezet e diellit u përzgjodh të jetë sfond dhe krah i djathtë i udhëheqëses.

Në kërkim të këndit më të mirë

Ashtu si presidenti Trump, edhe kancelarja gjermane e ka në zyrën e saj tavolinën vetjake të punës (fig 15/a). Aty, pas ndenjësës, përveç murit të bardhë, ajo mban tablonë e piktorit ekspresionist Kokoschka me subjekt paraardhësin e saj në kancelari dhe themeluesin e

Figura 15. Kolazh me imazhe të zyrës së kancelarisë; a: pamje e përgjithshme e zyrës me tre këndet dhe tryezat përkatëse; b: këndi i punës me tablonë e Konrad Adenauer-it në sfond; c: këndi i mbledhjeve dhe gjithashtu më i përdoruri nga kancelarja, pranë derës dhe vetratës së gjatë me pamjen nga jugu dhe parku i madh (Großer Tiergarten) i Berlinit d: këndi i takimeve me vetratën dhe pamjen e Reichstag-ut të shenjuar me rreth në sfond. (© 2020 The Press and Information Office of the Federal Government)





partisë CDU të drejtuar po nga ajo, Konrad Adenauer (fig.15/b). Por Angela Merkel ka zgjedhur të mos flasë nga tavolina e saj. Siç duket simulakra e ish kancelarit jetëgjatë të gjysmës demokratike të Gjermanisë (i asaj federales), sado i rëndësishëm, nuk është konsideruar mjaftueshëm gjithëpërfshirës, në çdo rast jo aq sa ndërtesa e parlamentit. Për të kuptuar përkushtimin ndaj përzgjedhjes së sfondit të drejtueses gjatë fjalimit Koronavirus, mund të na ndihmojë të kuptuarit e shpërndarjes hapësinore të zyrës së saj (Government, 2020).

Zyra e Merkel ndodhet në njërin nga këndet edhe katet më të larta të ndërtesës së kancelarisë. Ajo ka formë afërsisht trekëndore. Rreth e qark, nëpër perimetrin e hapësirës, ndodhen të shpërndara tre tryeza me tre përdorime të ndryshme. Më qendrore është tryeza, e sapopërmendur, e punës (fig.15/b). Pranë hyrjes së zyrës ndodhet një tavolinë e dytë, e gjatë dhe në dukje e përshtatshme për mbledhje (fig.15/c). Ajo është po aq e lartë sa tavolina e punës dhe në fakt, është vendi i preferuar i kancelares. Aty ajo kryen detyrat dhe pret vizitorët (Government, 2020). Vendi pranë dritares së orientuar nga jugu dhe pranë hyrjes, i ngrohtë dhe praktik, është këndi më i dashur dhe më i përdorur nga ajo. Tryeza e tretë është e ulët (fig.15/d), e rrethuar nga kolltukë të rehatshëm, e përshtatshme për biseda më të qeta. Në sfondin e këtij këndi pritjeje ndodhet dhe vetrata e madhe me pamje nga sheshi i Republikës

dhe Reichstag-u. Ky i fundit, jo tavolina e punës dhe as tavolina e rehatshme e mbledhjeve, është këndi i zgjedhur nga Kancelarja për fjalimin e saj.

Gjetja e vendit më të mirë

Teksa e vështrojmë më me kujdes hapësirën përreth kancelares zbulojmë disa mospërputhje mes sallonit të zyrës dhe vendit ku ajo mban fjalimin solemn. Mospërputhjen na e zbulon tavolina e përdorur gjatë fjalimit. Ajo është e drunjtë, e ngrohtë dhe ka një vizë të lehtë tërthore⁴ që kalon pranë duarve të folëses (fig. 9), ajo është e ndryshme nga tre tavolinat e zyrës së kancelarisë pasi ato janë të zeza me sipërfaqe të lëmuara dhe pa ndërprerje.

Për të kuptuar pak më shumë këtë mospërputhje le të përpiqemi të marrim me mend atmosferën dhe situatat hipotetike që mund të jenë krijuar përpara fjalimit të 18 marsit. Regjisorë imazhi dhe shpura asistentësh mbase lëviznin lart e poshtë nëpër kancelari. Ata do të kenë diskutuar se si tavolina e punës mund të ishte e përshtatshme, por sfondi me tablonë e Kokoschka-s jo, apo se si vendndodhja përpara vetratës mund të ishte e përkryer por tavolina e ulët nuk përcillte mjaftueshëm seriozitetin e mesazhit. Vallë a mund t'i kërkohet Kancelares të lëvizë një tavolinë tjetër tek ajo dritare? E kështu dikush do ketë ardhur me një zgjidhje,

4 Vija tregon që tavolina e përdorur nga kancelarja përbëhet nga disa pjesë.

ai ose ajo ka “zbuluar” të njëjtën prespektivë me të njëjtën pamje të parlamentit një kat poshtë zyrës së udhëheqëses, ose më saktë te dhoma e kabinetit të kancelarisë (fig. 16). Dhoma e madhe gjatësore, plot dritë, me mure të bardha, me mobilje të ngrohta druri dhe me dritaren identike me atë të zyrës të katit të sipërm, e hapur drejt Reichstag-ut, me sa duket është pranuar më në fund si vendi i duhur për fjalimin. Pra fjalimi nuk është mbajtur fare në zyrën e kancelares.

Dhoma e kabinetit përdoret kryesisht të mërkurave (Government, 2020) për mbledhjet e qeverisë gjermane. Pjesa më e madhe e hapësirës së saj mbushet nga tavolina vezake e stërmadhe rreth të cilës kancelarja drejton mbledhjet e kabinetit me ministrat federalë dhe të shtetit (fig 16/a). Ajo qëndron në mes krahut të gjatë të tryezës ovale (fig. 16/b). Përveç hapësirës qendrore të mbushur nga tryeza e madhe ka dhe një hapësirë tjetër, pranë vetratës që hapet nga parlamenti, të mobiluar me dy radhë tavolinash në formë gjysmëharkore (fig. 16/c). Te ky kënd ulen përfaqësuesit e brendshëm të kancelarisë, nga shefat e departamenteve e deri të mbajtësit e minutave. Me pak fjalë ekipi më i afërt i drejtueses, i gatshëm për ta asistuar atë gjatë mbledhjeve të gjata.

Kancelarja nuk e ka mbajtur fjalimin as te vendi i saj në mes të tryezës vezake. Ajo është ulur te radha e dytë e tavolinave që normalisht qëndrojnë diku në anë të saj, pra në këndin më periferik të dhomës, te tavolina e drunjte me atë ndërprejen vijore që kalon poshtë duarve

të saj. Në këtë rast asaj nuk i është dashur të zotërojë hapësirën përballë me ministrat hijerëndë, fundja ajo po i flet gjithë gjermanëve, madje edhe popujve të Europës, përmes objektivit të kameras. Sfondi është më i rëndësishmi, e bashkë me të afërsia me dritaren dhe pamja e qartë e parlamentit. Për të gjitha këto arsye, në minutat përpara fjalimit, ajo ka ecur drejt skajit të dhomës së kabinetit, ka zënë vendin e ndihmësve të saj të pasuruar posaçërisht për rastin me dy flamujt dhe ka filluar t'u flasë dëgjuesve të shqetësuar. Pas saj qëndron parlamenti gjerman aq i rëndësishëm sa për ta detyruar kancelaren ta braktisë rehatinë e zyrës. Tani na mbetet vetëm të kuptojmë përse kjo ndërtesës është kaq me vlerë? Çfarë përfaqëson ajo për Gjermaninë?

Në krye të qendrës së përbashkët

Në skenën e Angela Merkel-it mbizotëron mjedisi i jashtëm. Duket sikur po na thotë se ndarja nga hapësira publike, nga sheshi i zbratur poshtë dritares së saj, nuk do të jetë e përhershme, ai vazhdon të jetë aty e do t'i presë. Duhet vetëm pak durim. Dielli, qielli si dhe shteti gjerman në formën e Reichstag-ut vazhdojnë gjithashtu të jenë si përherë, si dhe vetë kancelarja.

Parlamenti është ndërtesa protagoniste e hapësirës pas shpatullave të kancelares, aq e rëndësishme sa e shtrëngoi atë që të braktiste zyrën e saj, megjithëse e rehatshme dhe fort dinjitoze. Ngrehina e parlamentit është hijerëndë, e gurtë, klasike, me rrënjët në të





Figura 16. Kolazh me imazhe të dhomës së kabinetit; a: pamje e sallës e cila ndodhet një kat më poshtë zyrës së kancelares (me shigjetë të bardhë është shënuar vendi ku ulet kancelarja); b: dhoma e parë nga këndi i kundërt i fotografisë paraardhëse gjatë një takimi zyrtar (me shigjetë të zezë është shënuar Angela Merkel) c: pjesa më fundore e dhomës me pamje nga Reichstag-u, ku qëndron ekipi i kancelares, dhe gjithashtu këndi i zgjedhur nga ajo për fjalimin. (© 2020 The Press and Information Office of the Federal Government)

kaluarën. Ajo flet përmes gjuhës formale neoklasike, gjuhë të cilën monarkët europianë, që nga koha e Rilindjes e kanë përzgjedhur për ndërtesat e pushtetit të tyre. Reichstag-u (Britannica, 2020) e nis rrugëtimin në vitin 1884, fill pas bashkimit të Gjermanisë, pasi perandori Vilhelm I, e ndërtoi për nevojat e shtuara të parlamentit të tij perandorak. Ca më vonë mbi të u gdhendën fjalët “*Dem Deutschen Volke*”, “*Për Popullin Gjerman*” që u panë si ogur i rënies së shpejtë të absolutizmit. Pas Luftës së Parë botërore dhe abdikimit të perandorit, në ballkonet e ndërtesës u shpall republika, u zhvilluan seancat e para pluraliste. Në sheshin përballë parlamentit u zhvillua protesta më e përgjakur e historisë gjermane, në atë rast për të drejtat e punëtorëve. Reichstag-u u la mënjanë vetëm në vitet kur në Gjermani sundonte nazizmi e më pas komunizmi. Me pak fjalë vetë ekzistenca e ndërtesës, e brendisë por dhe e sheshit të saj është pazgjidhshmërisht e lidhur me lirinë, me drejtësinë, me demokracinë. Ajo është shenjë e patundur dhe gjurmë e pafshirë e pushtetit të popullit.

Parlamenti u rikthye si protagonist në hapësirën e Berlinit pas rënies së murit dhe ribashkimit të Gjermanisë. Pak vite më vonë, ndërtesa u rikonstruktua plotësisht. Ca më vonë pranë saj u ngrit dhe ndërtesa e re e Kancelarisë, prej ku flet dhe Angela Merkel. Mesazhet e lidhura me lirinë dhe demokracinë përçohen mjaft fort sot më shumë se më parë, sidomos përmes kubesë së re të Reichstagu-t, e projektuar nga arkitekti britanik



Figura 17. Kubeja e përshkueshme e parlamentit gjerman projektuar nga Foster + Partners (© Harshiitart, licensed under CC BY-SA 4.0)

Norman Foster në vitet '90 (fig. 17). Ajo është praktikisht një përmbysje, jo vetëm formale por edhe simbolike, e kubesë klasike. Ajo është e lehtë, transparente, e arritshme. Ajo nuk është një objekt që vetëm soditet, por një hapësirë që përjetohet, dhe jo rastësisht falë konceptimit të ri të saj, parlamenti gjerman është sot ndër ndërtesat më të vizituara në Berlin (Britannica, 2020). Publiku, qytetarë gjermanë e turistë, ngjiten e lëvizin nëpër të duke u njësuar me hapësirën e pushtetit që ushtrohet nën ta, nga përfaqësuesit e zgjedhur, në sallën e madhe të parlamentit.

Kubeja e tejudkshme vjen te ne përmes dritares gjithashtu të tejudkshme të Kancelarisë dhe qëndron në mes të ekranit krah kokës së kancelares (fig. 13/c). Pra,

përfundimisht me sfondin e thjeshtë por të zgjedhur me aq kujdes, udhëheqësja po i thotë popullit të saj se pavarësisht këtij virusi ata janë të gjithë bashkë: shëndetësia, institucionet e shtetit, por mbi të gjitha, përmes parlamentit është aty i gjithë populli gjerman. Ata janë të bashkuar përmes vlerave demokratike. Këtë e thotë sfondi dhe natyrisht fjalët e Merkel-it:

“Ne jemi një demokraci. Ne nuk jetojmë të detyruar, por duke ndarë diturinë dhe pjesëmarrjen. Kjo është një detyrë historike dhe mund ta arrijmë vetëm bashkë” (Merkel, 2020)

Aleksandar Vučić

15 mars 2020. Shohim presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić (fig 18/a) duke folur përpara një sfondi blu të thellë, nga ato skenografitë e përkohshme prej bezeje, që ngrihen me skelet të lehtë e montohen posaçërisht për deklarata publike apo konferenca për shtyp. Bezja është blu dhe mbi të janë printuar dukshëm të gjitha shenjat, figurative dhe të shkruara, të nevojshme për të identifikuar institucionin e presidentit të republikës serbe.

Udhëheqësi serb nuk është vetëm në daljen e tij, ndyshe nga ai amerikan apo kancelarja gjermane. Pas tij, gjatë fjalimeve më të rëndësishme për emergjencën e koronavirusit qëndron një shpurë me njerëz, kryesisht

burra, ministra ose teknikienë të rreshtuar e gati për ndihmë. Kështu në fjalën e 15 marsit, gjatë së cilës Vučić lëshon një sërë deklaratash të forta, ai është i pari, dy hapa pas tij rri kryeministrja e vendit dhe një hap më përtej qëndrojnë përfaqësues të kabinetit qeveritar dhe profesionistët e lidhur me kundërpërgjigjen ndaj epidemisë.

I pari mes të barabartëve

Imazhit përpara nesh i mungon thellësia e prespektivës, falë dhe afërsisë së sfondit njëngjyrësh. Duket sikur kemi përpara një ikonë bizantine. Gardhi me silueta njerëzore dhe flamuj të rreshtuar mbizotërohet nga forma e udhëheqësit, shumë i madh dhe i lartë në krahasim me



Figura 18. Presidenti serb gjatë fjalimit të 15 marsit për emergjencën Koronavirus; a: presidenti flet para sfondit provizor të stolitur me simbolet e shtetit dhe presidencës, i shoqëruar nga kryeministria e vendit dhe drejtues të tjerë b: marrëdhënia e Vučić-it me stemën presidenciale, kurorën dhe mantelin (Faqja facebook e Aleksandar Vučić)

gjithë të tjerët. Pozicioni i tij kryesor theksohet dhe më tepër nga prania e stemës presidenciale, e cila e parë nga përballë i qëndron si brerore. Nga përballë duket sikur presidenti tashmë mban kurorën mbretërore mbi krye ndërsa pret t'i hedhin edhe mantelin për t'u bërë njësh me pushtetin (fig. 18/b). Në një afresk kishtar bizantin vendin e Aleksandar Vučić-it do ta mbante Krishti, shën Maria, mbreti ose perandori. Duke perifrazuar Rudolf Arnheim-in gjatë interpretimit të një mozaiku në kishën bizantine të Shën Vitale-s, të shekullit VI, me subjekt perandoreshën Teodora (fig. 19), mund të themi se gjatë fjalimit të tij, presidenti serb qëndron *“i pari mes të barabartëve”* (Arnheim, 1988). Ai po i siguron qytetarët e republikës së tij se: *“sot, të gjitha vendimet për luftimin e Koronës mbështeten te pikëpamjet e profesionistëve më të mirë, jo te politikanët”*



Figura 19. Teodora dhe pjesëmarrësit, Bazilika e Shën Vitale-s, shekulli VI (Vilém Smejkal licensed under CC PDM 1.0)

(Vučić, 2020)

Ndërsa mënyra e vendosjes në skenë, përpara dhe mbi teknicienët e ndihmës në të djathtë (fig. 20), nënvizon se sigurisht këto pikëpamje do të mbikëqyren nga ai.

Përtej pëlhurës

Kalimin drejt fjalëve më të forta të mesazhit presidencial do ta arrijmë përmes të kuptuarit të mëtejshëm të hapësirës ku mbahen fjalimet e rëndësishme të marsit. Nga një fotografi tjetër e atyre ditëve dhe e shpërndarë në faqen facebook të udhëheqësit (fig. 20), zbulojmë disa hollësi të rëndësishme të mjedisit arkitektonik përreth tij. Në të majtë të imazhit, pas shoqëruesve të presidentit, shohim se si pëlhura blu përthyeret përreth



Figura 20. Pamje nga fjalimet e marsit, ku shquhet trangu i një prej kolonave të sallës në të djathtë të udhëheqësit dhe fragment nga muralja pas sfondit blu (Faqja facebook e Aleksandar Vucic)

një element i këndor me formë cilindrike që ndryshe nga bezja nuk është aspak i përkohshëm. Çka shohim është fragmenti i një kolone monumentale dhe, pak më lart, pjesë nga një murale madhështore.

Pallati i ëndrrave

Hapësira e mbushur nga fjalët solemne të presidentit Vučić nuk është e një vendi çfarëdo. Gjendemi brenda sallonit kryesor të pallatit të ndërtuar për dinastinë mbretërore të Karadjodjevic-ëve i njohur si Novi Dvor apo Pallati i Ri (Belgrade, 2013). Ndërtesa filloi të ngrihej në vitin 1911 dhe u kthye në rezidencë

mbretërore vetëm pas Luftës së parë botërore. Ajo do të bëhej zyrtarisht shtëpia e mbretit serb, e adashit të presidentit të sotëm, Aleksandar I, në qershor të vitit 1922. Aleksandar Vučić po flet nga salla kryesore e pallatit mbretëror, sot presidencial, dhe kolona gjigante prej mermeri është veçse njëra prej shumë kolonave të tjera që qarkojnë perimetrin e hapësirës.

Nga disa pamje të tjera zbulojmë se kolonat janë dorike, dhe siç na thotë Vitruvi, të ideuara sipas përpjestimeve të mashkullit (Vitruvius, n.d.). Ato kolona përcjellin idealin e fuqisë burrërore të shtetit serb. Ivan Colovic në librin e tij *“The politics of Symbol in Serbia”* pohon se *viriliteti*, forca mashkullore e luftëtarit si dhe *besnikëria ndaj udhëheqësit* qëndrojnë në themel të vetëdijes kombëtare të këtij kombi (Colovic, 2002) dhe mbi këto dy narrativa janë ngritur shtylla të rëndësishme të identitetit kombëtar të Serbisë. Të gjitha këto tipare dalin në pah te marrëdhënia e ndërtuar në hapësirë, mes kolonadës dhe presidentit.

Historia e pallati të ri, të ndërtuar pasi i vjetri përballë tij, i ngritur për familjen rivale të Obrenovic-ëve, nuk mjaftonte më, përputhet me një moment shumë të rëndësishëm historik të Serbisë, me Luftën e parë botërore dhe pasojat e saj. Fundi i Luftës së Madhe, megjithë humbjet e shumta njerëzore që i shkaktoi Serbisë, do të shenjonte edhe zgjerimin më të madh të ndikimit serb në Ballkan që nga koha e perandorisë serbe të shekullit XIV. Ndërsa i vjetri ishte pallati i

a



b



Figura 21. Pallati Presidencial (Pallati i ri/ Novi Dvor) ose ish pallati mbretëror; a; ballina e pallatit nga kopshtet që përputhet dhe me sallën e madhe, të projektuar nga e para, nga arkitekti Milan Minić në vitet '48-'53 (Belgrade, 2013); b: Salla e madhe e qarkuar nga radhë kolonash dorike dhe me muralen (në këtë rast të mbuluar) në pjesën fundore (Belgrade-beat)

mbretit të serbëve, Novi Dvor u bë pallati i mbretit të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve e më pas i mbretit të Jugosllavisë. Te pallati mbretëror dhe kjo sallë madhështore trupëzohet ambicia e një vendi për të kryesuar fqinjët dhe për t'u përfshirë mes shteteve dhe kombeve më të rëndësishme europiane.

Dikotomia e hapësirës

Përveç kolonës dorike, vështrimi diagonal i skenës por dhe kërkimi i mëtejshëm i tipareve të saj na zbulon hollësi të tjera, të fshehura nëpër hapësirën e sallës mbretërore. Salla është gjatësore, me plan drejtkëndor. Në të dy anët e saj, pas kolonadave, gjenden dy murale të rëndësishme, me subjekte të ndryshme të lidhura me historinë e Serbisë. Këto vepra u vendosën në hapësirën e pallatit pas luftës së dytë botërore, në vitet '50 (Belgrade, 2013), ndërkohë që ndërtesa, pas rënies së mbretërisë, u përshtat për nevojat e republikës serbe, si pjesë e Jugosllavisë socialiste.

Muralja e parë qëndron e mbuluar pas krahëve të presidentit. Në të zhvillohet një skenë e kohëve moderne. Shohim punëtorë, gra, deri dhe një marinar, një figurë me veshje tradicionale, siluetat e thjeshtuara të një qyteti të ri dhe tela. Duke kërkuar mbi këtë vepër zbulojmë se ajo ka si autor piktorin malazez Milo Milutinović, ndërsa subjekti i saj është protesta popullore dhe grushti i shtetit i 27 marsit 1941 në Beograd. Atë ditë protestuesit rrëzuan qeverinë

dhe mbretin e tyre që sapo kishin nëshkruar *Paktin Trepalësh* që do t'i bënte aleatë dhe vasalë të Aksit nazifashist. Megjithëse roli i komunistëve në grushtin e shtetit ishte dytësor, falë *ideologjizimit* të mëvonshëm, komunistët e shpallën veten vendimtarë në atë ngjarje (Stojanovic, 2009). Ndodhia do të shenjonte fillimin e luftës për Jugosllavinë, pasi më 6 prill do të sulmohej dhe pushtohej nga Gjermania dhe më tej, fillimin e ngjitjes së komunistëve drejt pushtetit.

Muralja tjetër, po aq e madhe, ndodhet në anën e kundërt të sallës, përballë presidentit Vučić, ndërsa ai mban fjalimin e rëndësishëm. Ne si spektatorë e kemi të pamundur ta shohim, komunikimi mes imazhit dhe udhëheqësit është personal dhe ndodh jashtë planit të kameras. Në atë imazh pasqyrohet një skenë shumëngjyrëshe lufte, e realizuar nga piktori, gjithashtu me origjinë malazeze, Petar Lubarda. Subjekti i veprës është shumë e njohura betejë e *Fushë Kosovës*, mbase ngjarja më e himnizuar në ndihmë të identitetit kombëtar serb.

Pra salla mbretërore nga e cila flet Aleksandar Vučić na qenkësh një hapësirë e dyzuar, e ndarë mes dikotomisë, nacionalizëm serb - internacionalizëm jugosllav. Pas tij qëndron muralja socialiste, me temë nga e kaluara jugosllave, ndërsa përpara beteja e Fushë Kosovës që i përket jo vetëm të kaluarës por dhe të tashmes, mbase dhe të ardhmes, të një shoqërie ku retorika nacionaliste vazhdon të jetë shumë e fortë.



Figura 22. Dy skajet e sallës; a: muralja e Milo Milutinović, e vendosur në krye të sallës me subjekt grushtin e shtetit të 27 marsit 1941 (neweurope.eu); b: muralja e Petar Lubarda-s me subjekt betejën e Fushë Kosovës, (Belgrade-beat)

Solidariteti mes kombeve është përrallë

Le të ndalemi pak te muralja e Lubarda-s. Beteja e Fushë Kosovës e paraqitur në murin përballë Aleksandar Vučić është një etapë e dhimbshme e historisë së vendit ballkanik, pasi shenjon fillimin e sundimit otoman dhe të ashtuquajturës “*Nata Turke*” (John R. Lampe, 2020). Narrativat e historisë serbe, dhe jo vetëm, strukturohen përmes golgotash (Colovic, 2002) të herëpashërëshme ekzistenciale. Vetë pallati i ri u realizua përpara, gjatë dhe menjëherë pas njëres prej tyre, e njohur në historinë serbe si golgota shqiptare. Ajo lidhej me tërheqjen e detyruar të ushtrisë së mundur serbe, përmes Shqipërisë, drejt porteve të Adriatikut me destinacion Korfuzin (John B. Allcock, 2020). Aty ajo do të mund të rigrupohej për të rinisur betejat në një front tjetër. Tërheqja e karvaneve me dhjetra e mijëra serbë, ushtarë dhe jo vetëm, u kthye shpejt në një kalvar tragjik përmes maleve të ashpra të Shqipërisë, pa ushqim të mjaftueshëm, në mes të dimrit dhe në një mjedis jo miqësor.

Udhëheqësi i sotëm duket sikur po e përgatit popullin e tij për golgotën e radhës, për pandeminë e Koronavirusit të ri, ndërsa shikon betejën e përgjakur në gjenezë të kalvarit serb. Sipas mitit, në atë ngjarje, Serbia u sakrifikua për Europën. Sipas serbëve, Europa i braktisi ata atëherë, dhe gjithmonë më pas, duke mos ia njohur ose duke ia rrëzuar ambiciet popullit ballkanik.

Aleksandar Vučić i thotë popullit të tij se Europa

vazhdon të jetë mosmirënjohëse, pasi ajo e ka lënë dhe këtë herë mënjane Serbinë, në kulmin e pandemisë. Ai është koherent me hapësirën përreth, teksa flet duke u mbështetur te një tjetër shtyllë e nacionalizmit të djathtë serb, prej nga vjen dhe ai vetë, tek ideja e shtresëzuar e të ashtuquajturit “*perëndim i kalbur*”, apo “*Europa shtriga plakë*” (Colovic, 2002). Në vitin 2020, po të lemë mënjane teatrin politik, shumë gjëra vazhdojnë të jenë si përherë. Këtë e thotë dhe udhëheqësi i Serbisë, gjatë fjalës së tij:

*“...solidariteti i madh ndërkombëtar nuk ekziston, solidariteti evropian nuk ekziston, ai ishte një përrallë në letër”
(Vučić, 2020)*

Në gjurmët e Jugosllavisë

Pas Luftës së Dytë Botërore, roli i pallatit mbretëror, si një nga qendrat e pushtetit shtetëror të Jugosllavisë, u zbeh. Tito-ja nuk e zgjodhi atë si rezidencën e tij. Autoriteti socialist jugosllav, i udhëhequr nga një kroat, i ndërtoi ndërtesat dhe hapësirat e tij të shfaqjes së pushtetit tjetërkund nëpër Beograd. Pallati mbretëror gjithsesi qëndroi në shërbim të vazhduar të republikës serbe, nën kornizën jugosllave, duke u kthyer në mbartës së dikotomisë së sipërpërmendur, të formëzuar te dy muralet e vendosura ballë për ballë.

Kështu, duke kërkuar hollësi mbi jetën e pallatit të ri,



Figura 23. Tito gjatë darkës me pjesëmarrësit e konferencës së Beogradit, 1 shtator 1961 (Dissonantheritage)

zbulojmë një fotografi. Në të, Josip Broz Tito pozon krah presidentit indonezian Sukarno dhe drejtues të tjerë shtetesh (fig. 23). Pas tyre qëndrojnë po të njëjtat kolona dorike të sfondit presidencial të 15 marsit. Te kjo fotografi rigjejmë një tjetër tipar të udhëheqësve të Beogradit që, me sa duket, e ka infektuar edhe këtë hapësirë e bashkë me të edhe udhëheqësin e sotëm serb: oportunizmin.

Josip Broz Tito ishte ndër ideuesit e polit të tretë botëror që qëndronte jashtë aleancave të mëdha, të botës perëndimore dhe bllokut lindor socialist. Lëvizja Asnjëanëse, *Non Aligned Movement*, u zyrtarizua në

Beograd në vitin 1961 (Ancic, 2017). Fotografia e Titos në Novi Dvor është bërë gjatë një darke të konferencës. Në vetëm një dekadë e gjysmë, që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, udhëheqësi jugosllav ia kishte dalë të lidhte e të zgjidhte aleanca me të gjitha frontet botërore, me lindjen komuniste, me demokracitë perëndimore, dhe në vitin 1961 ishte me asnjërën prej tyre dhe njëkohësisht me pjesën më të madhe të botës. Në kulmin e emergjencës Koronavirus, presidenti serb, gjithashtu i mësuar të joshë njëkohësisht komunitetin europian, Amerikën dhe Rusinë, i hedh publikisht sytë drejt fuqisë më të re, drejt të njëjtës lindje të largët të ish udhëheqësit indonezian, teksa i thotë bashkëqytetarëve të tij se:

“Ne presim shumë dhe i kemi shpresat më të mëdha te të vetmit që mund të na ndihmojnë në këtë situatë të vështirë, dhe ajo është Kina” (Vučić, 2020)

Edi Rama

Flamuri kombëtar dhe një fotografi, të vetme, qëndrojnë në të dy krahët e kryeministrit të Shqipërisë gjatë fjalës së tij të 28 marsit 2020 (Fig. 24). Skena duket si rastësore, a thua se Rama ka shkuar në zyrë, ka kyçur dyert, ka mbyllur perden, ka ndezur dritën, është ulur në tavolinën e punës dhe ashtu i vetëm ka hapur kameran e kompjuterit ose celularin e tij. Këtë ndjesi e përforcojnë dhe elemente të tjerë krahas sfondit të varfër, bluza *casual* nën xhaketë dhe objektivi i kameras që qëndron poshtë portretit të folësit, siç e mbajmë shumë prej nesh ndërsa flasim online. Atmosfera e kësaj hapësire dhe e momentit të fjalimit duket e zhveshur nga teatraliteti, në pamje të parë më autentike

se skenat e kancelares gjermane, presidentit amerikan dhe atij serb. Ata i flisnin shikuesve të tyre përmes mjediseve dhe skenarëve të mirënjohur e të simular sa e sa herë. Donald Trump-i zgjodhi zyrën vezake, skenë e përdorur dhe nga paraardhësit e tij ndërsa Aleksandar Vučić foli nga një skenë tipike konferencash për shtyp. Mënyrat e përcjelljes së mesazhit Koronavirus, mes dy presidentëve dhe drejtuesit shqiptar dallojnë po aq sa dallon *Festivali i Këngës* nga *Big Brother* apo filmi *The Patriot* nga *The Blair Witch Project*. Baudrillard do ta përkufizonte skenën e zyrës kryeministore të Tiranës si *hiperreale, më reale se vetë realiteti*, e cila mbart me vete edhe një efekt anësor jo të parëndësishëm, *shembjen e realitetit* (Baudrillard, 1994).



Figura 24. Kryeministri i Shqipërisë gjatë fjalimit të 28 marsit, Rezistencë për Ekzistencë. (Faqja facebook e Edi Rama)

Qerthulli komunikues

Fjalimi i 28 marsit, i titulluar *Rezistencë për ekzistencë*, është relativisht i vonuar, më shumë se dy javë nga shfaqja e rasteve të para me Koronavirusin e ri, por kjo nuk është hera e parë që kryeministri u drejtohet shqiptarëve drejtpërdrejt dhe personalisht për këtë temë. Ai e ka bërë këtë sa e sa herë, më shpesh se të gjithë udhëheqësit e tjerë të trajtuar në këtë analizë.

Kështu në datat 9 e 10 mars, që përkojnë me rastet e para të epidemisë, ai do të fliste nga salla e mbledhjeve qeveritare, më pas nga zyra e tij e në vazhdim nga hapësira e zhveshur nga orenditë, e përzgjedhura e komunikimeve të krizës dhe e fjalimit të rëndësishëm të fundmarsit. Sikur të mos mjaftonte, kryeministri ka qenë aktiv edhe gjatë fundjavave nga hapësira e banesës

së tij, disa herë, përpara muresh të zhveshura betoni dhe bibliotekës të tejmbushur me libra. Për më tepër, mesazhet e tij të shpeshta e të dendura janë inflacionuar edhe më tej nga mbiprodhimi i informacionit i diktuar nga situata e jashtëzakonshme.

Mënyrat e përcjelljes së mesazhit në ditët pandemisë nuk janë të reja për udhëheqësin shqiptar. Prej vitesh mediumi i parapëlqyer i tij është facebook-u. Shpeshherë e sidomos gjatë ngjarjeve jo të zakonshme, ai është gjithmonë aty në komunikim me ndjekësit e tij në kohë reale. Ai shpërndan mesazhin dhe ata i përgjigjen po aq shpejt, e përgëzojnë ose e kritikojnë. Sidomos ata më kritikët, shpesh, marrin përgjigje të drejtpërdrejtë nga vetë kryeministri, duke ndërtuar menjëherë të ashtuquajturin "*qarkullim mes dy poleve*" (Baudrillard, 1994), mes dërguesit dhe marrësit. Kjo mbivendosje krijon lëmshnaja të paqarta informacioni ku dy polet, kryeministri dhe qytetari, kapërcejnë muret e realiteteve përkatëse. Në këtë rast shkëmbimi i ndërsjellë mbizotërohet nga ai që ka më shumë ndjekës dhe ka narrativën më të fortë. Efekti tjetër anësor, i këtyre situatave është *humbja e rëndësisë së vetë mesazhit*. Bashkëveprimi bëhet qëllim në vetvete, mesazhi humb kuptimin ndërsa realitetit i tij nis të shembet.

Në prag të fjalimit të 28 marsit, kryeministri, mesa duket, ka arritur të kuptojë që qartësia e mesazheve të tij është dëmtuar nga modeli qarkullues i informacionit të përdorur nga vetë ai. Mesazhet e tij të njëpasnjëshme të ditëve të para nën epidemi, kanë humbur mes *shkretëtirës*

së reales dhe ekstazës së komunikimit (Baudrillard, 1983), mes mbiprodhimit dhe reagimeve. Kështu, mesa duket, ai ka vendosur të ndalojë, për të lënë më në fund një shenjë në zinxhirin e ngjarjeve përmes të cilave do të ndërtohet historia e Koronavirusit të ri. Këtë shenjë ai përpiket ta vulosë përmes shprehjes hijerëndë: “*Rezistencë për ekzistencë*” (Rama, 2020).

Një zanafillë e rezistencës për ekzistencë

Një zanafillë për këtë togfjalësh, mjaftueshmërisht i fuqishëm sa për ta kthyer në titullin e fjalimit më të rëndësishëm të pandemisë që ka kapluar edhe Shqipërinë, mund ta gjejmë në një prej zonave më të trazuara të botës, në territoret në konflikt të përhershëm, dikur mes Perëndimit e Lindjes, sot mes Izraelit dhe palestinezëve. Konkretisht tek ideologjia e njohur si *sumud* e që në gjuhën arabe do të thotë “i patundur” (Rijke & Teeffelen, 2014). Ajo u përhap në vitet ‘60 e ‘70 mes palestinezëve që jetonin në kampet e refugjatëve në Liban. Fillimisht nisi si reagim dhe u kthye gradualisht në mënyrë jetese.

Asokohe mes popullsisë së kampeve u rrit *Organizata për Çlirimin e Palestinës* (OÇP), përkrahëse e luftës së armatosur kundër Izraelit. Irredentizmi i tyre do t’i kthente vendbanimet palestineze, kampet e tyre, në shënjestra sulmesh të dhunshme nga brenda Libanit, nga Siria e natyrisht nga Izraeli (CrisisGroup, 2009). Kështu, natyrshëm, tiparet fillestare të *sumud*-it



Figura 25. Murale e realizuar mbi murin ndarës mes Izraelit dhe Palestinës. (Creative Commons)

lidheshin me mbrojtjen e familjes dhe komunitetit *pra me urgjencën ekzistenciale* (Rijke & Teeffelen, 2014) e të rezistuarit për të ekzistuar.

Koncepti origjinal, me kohën, u përhap përtej kampeve, jashtë vendit, nëpër të gjitha territoret e banuara nga populli palestinez dhe hap pas hapi, u shndërrua në tipar kulturor kombëtar të një kombi në përpjekje për të ndërtuar shtetin. Sot ai e ka tejkaluar aspektin origjinal të betejës së armatosur dhe mbijetesës, duke u pasuruar me aspekte njerëzore, kulturore të lidhura me përditshmërinë e jetës. E djeshmja dhe e sotmja e idesë perifrazohen në një murale të njohur mbi murin kufitar të ngritur së fundi nga Izraeli në të cilën shkruhet:



Figura 26. Kopertina (Profile Cover) e profilit facebook të kryeministrit shqiptar, gjatë muajit të parë të pandemisë. (Faqja facebook e Edi Ramës)

“*to exist is to resist*” (Fig. 25), pra vetë ideologjia dikur e formësuar si mur në mbrojtje të komunitetit, sot i lufton ato. Një përkufizim të plotë të kulturës së sotme të *sumud-it* na e jep citimi i mëposhtëm:

Nuk vlen të mbjellësh një pemë dhe të thuash: “Ky është sumud”. Por duhet ta ushqesh pemën, ta krasitësh, t’i vjelësh frutat, duhet të krijosh një atmosferë më të shëndetshme për të gjithë... Sumud është art i të jetuarit... dhe i ndërtimit të marrëdhënieve mes njerëzve”⁵ (Rijke & Teeffelen, 2014)

Duke iu kthyer kontekstit shqiptar dhe huazimit të këtij koncepti, mund të themi se së paku një mesazh i është ngulitur të gjithëve gjatë javëve të rrëmujës informative:

⁵ Përkufizimi i përdorur në shkrimin e cituar i përket Zougbbi Zougbbi, një figurë e njohur në Palestinë për ndërtimin e urave mes komuniteteve vendase.

“*kjo është luftë!*” (Rama, 2020). Këtë, drejtuesi shqiptar, e ka përsëritur edhe më parë ndërsa në fjalimin e 28 marsit e thotë plot katërmbëdhjetë herë. Këtë e bën jo vetëm me fjalë por dhe me sfondet e tij. Te sfondi i realitetit të tij fizik, siç do të shohim më poshtë, ai do ta shprehë më hollë të përzier dhe me mesazhe të tjera, ndërsa në sfondin e realitetit të tij kryesor digjital, në atë të facebook-ut, e thotë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Te kopertina e përzgjedhur (*profile cover*) pas fotos së profilit (*profile picture*) qëndron imazhi i një mjedisi të përgjakur nëpër të cilin lundrojnë truptha koronavirusi, shoqëruar me fjalët: “*Larg nga bombat!*” (Fig. 26).

Fjala e kryeministrit shqiptar, në Shqipërinë e pandemisë dhe distancimit social, në një kohë kur marrëdhëniet duhen kufizuar sa më shumë, ngrihet mbi shtratin më arkaik të konceptit *rezistencë për ekzistencë*, atë të mbrojtjes, mbijetesës dhe ngritjes së mureve përballë armikut:

“Pse nuk doni ta kuptoni se kjo është luftë me kuptimin më të plotë të fjalës, madje një luftë e pashoqe, sepse është e para luftë në historinë e njerëzimit ku njerëzimi nuk e sulmon dot armikun, por vetëm duhet të mbrohet prej tij?!” (Rama, 2020)

Hapësira qëllimisht e pamenduar

Përpara se të diskutojmë më tej mbi mesazhin e fjalimit të lidhur me hapësirën, le të qëndrojmë dhe pak te një element që na tërhoqi vëmendjen menjëherë: te varfëria



Figura 27. Disa nga sfondet e Edi Ramës në vite; a: Sfondi me kartolinën e vjetër të Tiranës, printuar në muret e brendshme të zyrës në bashki (Constantine Callaghan) ; b: Sfondi i kuq në zyrën e tij në selinë e Partisë Socialiste, gjatë një fotoje me përgjegjësin e tij për komunikimet publike (Shqiptarja.com); c: Në sallën VIP të aeroportit Nënë Tereza me Papa Françeskun (Top Channel); d: Gjatë vendosjes së pllakës së parë të bulevardit të ri (Kryeministria.al)

e pazakontë e hapësirës së përzgjedhur për fjalimet e pandemisë. Të jetë kjo vërtetë një zgjedhje rastësore? Hapësirat e komunikimit të Edi Ramës, në të shkuarën, kanë qenë gjithmonë të pasura dhe deklamuese. Të tilla kanë qenë fotografia 180 gradëshe e Tiranës së vjetër në zyrën e tij në bashki (Fig. 27/a), muri i kuq në zyrën e Partisë Socialiste (Fig. 27/b) apo fotot e vjetra murale të salla VIP e aeroportit të Tiranës ku u luajt akti i parë dhe i fundit i vizitës historike të Papa Françeskut në Shqipëri (Fig. 27/c). Madje edhe kur vendoste pllakën e parë të bulevardit të ri, nën qiellin e hapur dhe gjatë një dite të acartë janari, pas tij qëndronin të vendosura me kujdes dy fadroma,

madhështore por kokëulura (Fig. 27/d). E megjithëse shembujt e shkuar mund të duken të mjaftueshëm për t'i dhënë përgjigje pyetjes së ngritur, le të reflektojmë dhe pak mbi rastësinë ose jorastësinë e sfondit të 28 marsit. Mbase kriza Koronavirus është kaq serioze sa vërtetë këtë herë kryeministri nuk ka dashur të merret me gjëra në dukje sipërfaqësore, si dekori i skenës së radhës.

Në ndihmë na vjen një fjalim tjetër, më i afërt në kohë dhe rëndësi me fjalimin solemn për krizën e pandemisë. Në fundin e dhjetorit të 2019-s Edi Rama, i ulur e nga zyra e tij, iu drejtua shqiptarëve në mbyllje të një viti shumë të vështirë, pasi vetëm pak javë më parë kishte rënë një tërmet shkatërrimtar me dhjetra viktima e miliarda dollarë dëme. Sfondi dhe hapësira përreth tij atë ditë ishte një vorbull shumëngjyrëshe elementesh (Fig. 28/a). Aty ishin vizatimet e tij të mirënjohura të shtypura në mur, dy rafte të vjetër në të dy krahët, fotografi, një pendë portokalli, libra arti, objekte artistike, simbolike, vazo, shumë gota e kuti të mbushura përplot me mjete vizatimi. Çdo gjë dukej si përherë, në atë fjalim por me një dallim, vendndodhja e pazakontë e tavolinës. Pozicioni i saj nuk është i përhershmi. Tryeza e udhëheqësit, në përditshmërinë e punës, qëndron pranë dritares (Fig. 27/b). Siç duket atë ditë, përpara fjalimit të fundvitit, sfondi me dritare i është dukur i pamjaftueshëm. E kështu duhet të ketë udhëzuar ndihmësit që ta rrotullojnë plotësisht tavolinën duke e shkëmbyer sfondin mes dy dritareve



Figura 28. a: Sfondi dhe hapësira e zyrës gjatë fjalimit të fundvitit 2020 (VizionPlus/youtube); b: vendndodhja e zakonshme e tavolinës së punës pranë dritares (S. Karabell); c: me sekretarin e shtetit amerikan John Kerry, përballë faqes së murit që zgjidhet si sfond posaçërisht për fjalimin e fundvitit 2020 (Departamenti i Shtetit)



me sfondin mes dy rafteve të vjetër në murin përballë (Fig. 27/c). Këto të fundit i kanë dhënë skenës thellësi dhe kanë shtuar hapësirën e ekspozimit për tërësinë e objekteve që mesa duket ai dëshironte të na i tregonte. Pra edhe atë ditë në mbyllje të një të viti të vështirë, skena nuk i ishte lënë rastësisë. Edhe këtë herë, gjatë fjalimit solemn mbi rrezikun e pandemisë globale, s'ka pse të jetë ndryshe: edhe sfondi i varfër i datës 28 mars duhet të jetë qëllimisht i pamenduar.

Fshehja e automatizmave

Dhe tani le t'i kthehemi marrëdhënies mes hapësirës dhe mesazhit të asaj dite. Njësoj si sfondet e sipërpërmendura edhe hapësirat e kryeministrit janë pjesë e rëndësishme e imazhit publik të udhëheqësit. Prej tyre ai u drejtohet shpesh shqiptarëve. Vitet e fundit e kemi parë të na flasë duke ndenjur përpara sfondit të stolitur me skicat e tij personale e shumëngjyrëshe, të cilat mbulojnë të gjitha muret e zyrës shtetërore. Pamë se si ato ishin aty dhe gjatë fjalës së fundvitit 2019. Ato ishin aty dhe me datë 11 mars të pasnesërmen e zyrtarizimit të epidemisë dhe në Shqipëri, por menjëherë më pas u zhdukën, u fshehën nga komunikimi zyrtar i krizës për të mos u shfaqur për më shumë se një muaj.



Figura 29. Gjatë bashkëbisedimit të 11 marsit, gjithashtu paraqitja e fundit për muajin mars, nga zyra e zakonshme e punës. (Faqja facebook e Edi Ramës)

Nëpër hiperrealitetet e udhëheqësit

Më 11 mars kryeministri do të mbante bashkëbisedimin⁶ e tij të fundit nga zyra e zakonshme e punës (Fig. 29). Skena hapëse zhvillohet në tualet, ndërsa ai me shpinë nga ne po lan duart. Në dukje po jep shembullin e mirë, se si duhet ruajtur higjiena, por në fakt përmes situatës, këndit dhe vendit të pazakontë, po përpiqet të na mbërthejë në realitetin e tij, tepër real, a thua se jemi mes miqsh që ndërsa shëtisim lirshëm kudo nëpër hapësirë, diskutojmë edhe për temën e ditës. Më pas ai na përcjell dhe në zyrë duke na e treguar atë shkarazi, pas shpatullave, derisa ulet në tavolinën e tij, ku nis të na flasë edhe më shtruar.

Me datë 23 mars drejtuesi do të na ftojë përsëri në bashkëbisedim nga hapësira e re, ajo e fjalimit *Rezistencë për ekzistencë*, me të cilën jemi familjarizuar tashmë prej më shumë se një jave (Fig. 30). Edhe këtë herë, ai na përfshin në një situatë të pazakontë. Sekuenca filmike e këtij fjalimi nis nga hyrja e dhomës. Aty përballemi menjëherë me kryeministrin, fare vetëm.

6 Përkufizim i përdorur nga vetë kryeministri në rrjetet e tij sociale.



Figura 30. Gjatë bashkëbisedimit të 23 marsit ku bëhet dhe prezantimi i këtij mjedisi gjithashtu brenda kryeministrisë (megjithëse kishte disa kohë që përdorej tashmë) i përzgjedhur për komunikimet e pandemisë (Faqja facebook e Edi Ramës)

Ai rrethohet nga karrige të zbrazura në mes të mjedisit spartan, me muret e zhveshura, ndërsa është tërësisht i zhytur në ekranin e një laptopi. Shoqëri i bën vetëm portreti i Ismail Qemalit dhe flamuri kombëtar. Pa prituri të na ftojë, ne futemi dhe lëvizim nëpër dhomë, përreth, përpara tij dhe pas infrastrukturës teknike e utilitare, në ndihmë të komunikimeve me publikun. Në mbyllje të ecjes i ulemi pranë, mbrapa telefonit të kapur te mbajtësja e posaçme dhe mjaft e sofistikuar. Vetëm në këtë çast ai i heq sytë nga grafiku në ekranin e kompjuterit, kthehet nga ne dhe fillon të na flasë përsëri shtruar, duke na parë në sy. Në paqartësinë e krijuar të të qenit metaforikisht pas ekranit apo fjalë për fjalë pas tij, udhëheqësi, si dërgues, depërton përsëri në realitetin tonë e na tërheq në hiperrealitetin e zyrës së tij të re.

Gjithashtu, gjysmërrethi i përshkuar nëpër zyrë deri në fillimin e bashkëbisedimit, nuk ka qenë i heshtur por është shoqëruar me një zhurmë gërvishtëse dhe shqetësuese. Ajo ngjan si e huazuar nga filmi i realizmit socialist shqiptar *Rrethi i Kujtesës*, gjatë së cilit zbulohet se me tinguj të ngjashëm, ishte torturuar Margarita, protagonistja, gjatë eksperimentimeve çnjerëzore në një kamp nazist (*Rrethi i Kujtesës*, 1987). Ajo përputhet dhe me të ashtuquajturën *Curve Squeal Noise* (Thompson, 2008), ose e thënë më thjeshtë, me zhurmën e krijuar nga fërkimi i disqeve të trenit në anët e shinave.

Falë edhe gërvishtjes çoroditëse, fjalët e kryeministrit, në vijim të bashkëbisedimit, bëhen edhe më të kuptueshme, realiteti i fjalimit bëhet edhe më i gjallë prej nxitjes së shqisë së të dëgjuarit ndërsa kontrasti i krijuar na lë të kuptojmë se realiteti i kësaj zyre është i arsyeshëm ndërsa informacioni që vjen nga jashtë saj, është zhurmues⁷.

Brenda surrealistit të tij

Hapësira e komunikimeve të krizës është një variant i kursyer i zyrës së zakonshme. Më e vogël, më pak e mobiluar, me më pak ngjyra e vetëm me disa karrige të zbrazura e të shpërndara rreth e rrotull. Zyrës modeste i janë kursyer dhe shenjat abstrakte të Edi Ramës, të

⁷ Në një mesazh dërguar shqiptarëve, përmes telefonit, gjatë ditëve të para të pandemisë, kryeministri ndër të tjera do të theksonte: "Ruaju nga informacioni i rremë".

cilat u ngjizën fillimisht në bllokun e punës, gjatë takimeve me burokratët e bashkisë. Ato janë dëshmi arratisjesh të përkohshme nga realiteti i atyre orëve, në thellësi të botës së tij të brendshme.

Vizatimet janë shumë të ngjashme nga dukja dhe procesi gjenerues me *automatizmat* ose shenjat që qëndronin në themel të lëvizjes kulturore të *surrealizmit*. Sipas Andre Breton-it, autor i *manifestit surrealist*, automatizmat në gjendjen e tyre më të pastër diktohen prej mendimit të çliruar nga arsyeja (Breton, 1924). Carl Jung-u, teoritë e psikologjisë të të cilit patën ndikim te surrealistët, na jep një këndvështrim të tijin mbi origjinën e rrugëtimit të këtyre shenjave nga nëndërgjegjja drejt realitetit. Sipas tij, pjesa më e thellë e ndërgjegjjes tonë apo nëndërgjegjja kolektive, është hapësirë e përbashkët e njerëzimit e formësuar brez pas brezi e përvojë pas përvoje. Ai shkruan se:

“përsëritja e vazhduar i ka gdhendur përvojat në strukturën tonë psikike në formë imazhesh” (Jung, 1981)

Këto imazhe, gjatë shekujve, kanë marrë trajta të qarta duke u kthyer në *arketipe* që përsëriten, ato:

“janë produkte të pastra të natyrës, të pafalsifikuar nga asnjë qëllim i ndërgjegjshëm” (Jung, 1981)

Jung-u gjithashtu shkruan se këto forma janë a priori, që e kanë *burimin te ëndrrat* dhe shpesh janë fantazi që dëshirojnë të bëhen realitet. Ndërsa Andre Breton-i, te manifesti i tij, deklaroi se surrealizmi beson në *“realitetin sipëror”* të këtyre formave, në *“mbifuzin e ëndrrës”* dhe se ai mund të zëvendësojë çdo mekanizëm tjetër psikologjik në *“zgjidhjen e problemeve kryesore të jetës”* (Breton, 1924).

Shenjat deklamuese, dikur vetëm pjesë e nënndërgjegjjes së kryeministrit, janë bërë pjesë e shpesh të jashtësisë së tij dhe e rrethojnë përtej hapësirës së tij personale, në hapësira ekspozitash ndërkombëtare, në botime apo në muret e zyrës së tij të punës të vizituar nga dhjetra krerë shtetesh. Ato qëndrojnë aty pasi janë ‘dëshmi’ e marrëdhënies së drejtuesit me realitetin sipëror të surrealistëve tek i cili jo të gjithë janë në gjendje të depërtojnë dhe e ëndrrave të tij që zanafillën e patën në një bllok dhe që shumë shpejt nisën të materializoheshin në fasadat e Tiranës dhe më tej.

Por gjatë krizës Koronavirus, ndryshe nga fjalimi i pastërmetit ai zgjedh të bashkëudhëtojë me të tjerë elemente e jo me automatizmat e tij. Dhe kështu lind pyetja e radhës. Cila mund të jetë arsyeja e kësaj zgjedhjeje?

Për të kuptuar mungesën duhet të shohim me kujdes ndryshimet në natyrat e dy ngjarjeve, tërmetit dhe pandemisë. Tërmeti goditi menjëherë, me fillimin erdhi dhe fundi i tij së bashku me pasojat shkatërruese. Kundërpërgjigja ishte domosdoshmërisht

prapavepruese, ndërsa narrativa e saj u ndërtua përreth energjisë fizike dhe instinktit të liderit, i cili ishte natë e ditë në lëvizje nga njëra rrënojë te tjetra, në sheshe, në hotele me të pastrehë e në komitete rindërtimi, i pakursyer, duke dhënë zemër dhe zgjidhje. E gjithë kjo kulmoi me atë fjalim të fundvitit ku ai, përmes shpërthimit pamor të skenës, u tregonte ndjekësve edhe për energjinë e tij të brendshme, forcën e tij shpirtërore dhe krijuese, fakt që nuk harron ta kujtojë dhe gjatë fjalimit të pandemisë:

“Kur ra tërmeti, e patë që ju dola për zot e nuk ia lash Zotit të bëjë asnjë nga detyrat që më takojnë mua” (Rama, 2020)

Por fatkeqësia e Koronavirusit të ri ka një natyrë tjetër. Ndërsa ia dimë fillimin, jemi të pasigurtë për fundin. Ndoshtemi përballë një njëpasnjëshmërie ngjarjesh me një fund të mjegullt. E nesërmja ngjan me një fushë të minuar nëpër të cilën çdo hap mund të jetë vdekjeprurës për shoqërinë e rrjedhimisht për vetë pushtetin. Situata ka nevojë për ndërhyrje *paravepruese*, pasojat e të cilave vetëm mund të imagjinohen:

“Çfarë kërkoni ju nga unë, që t’ju tregoj përralla?! Që t’ju them mos dilni por po dolët s’ka gjë, se më e mira do bëhet prapëseprapë?!” (Rama, 2020)

Ndërsa te fjala e mbajtur në prag të 2020-ës vëmendja ishte tek e ardhmja, më 28 mars, ajo është është tek e tashmja, e shumta tek e *ardhmja e të tashmes*, tek i infektuari, te viktima, te segmenti i radhës i kurbës ngjitëse. Energjia dhe të vepruarit instinktiv është i pavend ndërsa duhet qetësi dhe përgjigje shkencore. Kështu, Shqipëria si një pjesë e mirë e botës zgjedh të izohet, të kyçet, të ndalojë, të bëhet më e thjeshtë. Ritmet e përditshmërisë tkurren, e bashkë me të dhe vetë informacioni bëhet më i varfër duke qenë se tashmë përqendrohet më së shumti përreth temës së pandemisë.

Kjo ka ndodhur dhe te hapësira e kryeministrit, nga ajo janë zhdukur dhjetra elemente nëpër të cilat vështrimi i vrojtuesit, më parë, lodronte pareshtur. Nga sfondi janë zhdukur edhe *automatizmat* shumëngjyrëshe. Prej hapësirës së fjalimit janë hequr dhe vetë ngjyrat, çdo gjë është bardhezi, përveç të kuqes së gjakut të flamurit shqiptar. Jemi në luftë, e në luftë nuk ka vend për shkapërderdhje qoftë dhe me natyrë vetëm pamore. Kështu, pas tij qëndrojnë vetëm flamuri kombëtar, i kudogjendur, dhe fotografia e kryeministrit të parë shqiptar, Ismail Qemali.

Simulakra e paraardhësit

Përtej mënyrës së ndryshme të përcjelljes së mesazhit, përmes *estetikës së hiperreales* (Baudrillard, 1994), elementet e sfondit të kryeministrit shqiptar kanë

ngjashmëri me ato të udhëheqësve të tjerë. Edhe ai komunikon përmes imazheve të së shkuarës. Presidenti amerikan mbante babain, kancelarja Merkel ndërtesën e parlamentit, udhëheqësi serb ishte në pallatin e mbretit Aleksandar, ndërsa pas udhëheqësit shqiptar qëndron paraardhësi i tij, imazhi i njeriut që shpalli pavarësinë e vendit që drejton. Për të kuptuar përse ajo fotografi është aty, në të djathtë të tij, mund të na ndihmojë shpjegimi se kush ishte Ismail Qemali? Ose më saktë, kush është ai për ne shqiptarët?

Dallimi mes dy pyetjeve është i rëndësishëm. Për të kuptuar vërtetë se kush ishte ai do të na duhej prania e tij për së gjalli. Edhe sikur kjo të ishte e mundur, përsëri, garancia se ai do ishte plotësisht i sinqertë me ne kishte për të qenë e brishtë. Për këto arsye do të na duhej të ballafaqonim dëshmitë e tij me ato të bashkëkohësve, pra t'i ngjallim dhe ata, t'i kalonim fjalët e palëve nëpër lupën e poligrafëve, hetuesve, kërkuesve e psikologëve. Edhe sikur ta mundësonim këtë proces, i gjithë ky informacion do duhej të kalonte dhe nëpër subjektivitetin e nxjerrjes së përfundimeve. Për të gjitha këto arsye pyetja e parë bie, ajo është e pakuptimtë. E kemi të pamundur ta dimë se kush ishte Ismail Qemali. Në të kundërt është e mundur të tentohet përgjigja e pyetjes së dytë: si është ndërtuar imazhi i Ismail Qemalit për shqiptarët?

Për t'u përgjigjur nuk na duhet aspak Ismaili i vërtetë por na mjaftojnë kopjet, simulakrat e tij të rindërtuara nëpër filma, nëpër libra historie dhe nëpër fotografitë e

shumëfishuara zyrave të institucioneve të shtetit shqiptar. E ndërsa nuk mund ta dimë kurrë të vërtetën e plotë të Ismail Qemalit prej mishi, ne njohim të vërtetën e kopjeve të tij me të cilat jemi rritur. E ato kopje nuk gënjejnë, ato ndjekin një skenar transparent, të qartë pra janë të sinqerta brenda realitetit të tyre. E shumta mund të mos përputhen me origjinalin, e vërteta e të cilit është gjithsesi e dyshimtë. Kështu, po të pyesim cili është më i vërtetë, Santa Claus-i që sjell lodrat me slitën fluturuese apo San Nicola i varrosur në katedralen e Barit, përgjigjet do të ishin të ndryshme nëse pyetjen do t'ia bënim një fëmije apo një besimtar të krishterë. Siç thotë dhe Boudrillard, që në krye të librit të tij *Simulakra dhe Simulimi*, duke cituar një frazë nga Ecclesiastes:

“Simulakra nuk e fsheh asnjëherë të vërtetën – e vërteta fshihet pas faktit që nuk ekziston. Simulakra është e vërtetë.”
(Baudrillard, 1994)

Pra në përfundim mund të themi se për të kuptuar simbolikën pas fotografisë do të na mjaftojë të zbërthejmë Ismailin që njohim, të përshkruar te fjalori enciklopedik shqiptar, te tekstet shkollore, te vjershat për fëmijë, nëpër videoklipet e hedhura në youtube, në wikipedia e mbi të gjitha te personazhi kryesor i filmit *Nëntori i Dytë* luajtur nga Sandër Prosi. Nëpër to ndodhet Ismaili i realitetit tonë dhe i fotografisë së varur në zyrën e fjalimit.

Ismaili sipas nesh

Ismail Qemali në krah të Edi Ramës shfaqet përmes një fotografie. Fotoja në mur flet për një lidhje të hershme mes tyre, e vjetër të paktën sa pushteti i drejtuesit aktual. Ishte ky i fundit që në shtator të 2013-ës, javën e parë të marrjes së pushtetit, vendosi që nëpër zyrat shtetërore të mbahej portreti i paraardhësit. Kjo foto është rikopjuar e rishpërndarë me qindra e mbase mijra herë, pra ka kaluar nëpër të ashtuquajturin proces të riprodhimit mekanik. Sipas Walter Benjamin-it ky proces çon në shkatërrimin e aurës së origjinalit, kulti i tij zhduket e imazhit i mbeten vetëm cilësitë ekspozuese (Benjamin, 1969). Pra, mos vallë rrezikojmë që te ky Ismail bredharak, sa nga njëra zyrë në tjetrën, të mos shquajmë dot cilësitë e origjinalit, ose së paku të origjinalit sipas nesh?

Përgjigjen për këtë dyshim të fundit na e jep menjëherë vetë Benjamin-i i cili thekson se pavarësisht riprodhimit, kulti i origjinalit ruhet te fizionomia e fytyrës njerëzore. Jo më kot, thotë ai, fotografitë e para ishin kryesisht portrete të njerëzve tanë të dashur:

“Kulti i kujtesës së të dashurve tanë, në mugesë ose të vdekur, na ofron strehën e fundit për vlerat adhuruese të fotografisë. Aura emanohet për të fundit herë në fotografitë e hershme përmes

*shprehisë fluturake të fytyrës njerëzore.
Ky është trishtimi dhe bukuria e tyre e
pakrahasueshme” (Benjamin, 1969)*

Pra aura e plakut të Vlorës është akoma aty, pavarësisht kopjeve të fotografisë së tij, ai nuk mund të ikë për sa kohë tiparet dhe vështrimi i tij, të përjetësuara këtu e një shekull më parë, do të vazhdojnë të jenë të njëjtat, pavarësisht ndryshimit të letrës së printimit.

*“Ti që po pagëzon vatanë bëhu kumbar
dhe në këtë vatër” (Nëntori i dytë, 1982)*

Këto fjalë thuhën gjatë një dialogu në kasollen e një fshatari, te të njëqindtat, diku në fushën e Myzeqesë, pasi ky i fundit kishte vendosur në prehrin e Ismailit fëmijën e shtëpisë dhe një palë gërshërë (Fig. 31). Kjo ngjarje, marrë nga filmi *Nëntori i dytë*, zbulon tiparin e parë të figurës së Ismailit Qemalit, atë të *kumbarit të pavarësisë*. Kumbari është babai shpirtëror që qëndron pranë të pagëzuarit dhe është dëshmitar i lidhjes së tij me Zotin. Ai duhet të sigurohet që i pagëzuari do të ndjekë udhën e duhur përgjatë rrugëtimit të tij tokësor. Ky tipar atëror del në pah edhe te nofka dashamirëse me të cilën ne shpesh e thërrasim, *plaku i Vlorës*. Fjala *plak* në gjuhën shqipe nënkupton mençuri, babain dhe kryetarin e familjes, dikë që është mbi palët e mund të zgjidhë mosmarrëveshjet.



Figura 31. Ismail Qemalit i kërkohet të bëhet kumbari i fëmijës së shtëpisë (Nëntori i Dytë/ youtube)

Plaku i Vlorës përshkruhet gjithashtu si një njeri në lëvizje sa nga njëra qoshe e anës tonë të botës në tjetrën. Nga Stambolli, në mbledhjen e Bukureshtit, në Vjenë, në intervista në shtypin botëror dhe vizita në kancelaritë ndërkombëtare (RPSSH, 1985). *Nëntori i Dytë* nis me një mesazh nga larg i cili zbardhet përmes shiritit të telegrafit. Aty fillon dhe rrugëtimi shqiptar i Ismailit (Fig. 32).

Sekuencat filmike vazhdojnë me një vapor dhe disa varka në vozitje. Ismail Qemali po kthehet dhe po lundron drejt bregut shqiptar. Aty, radhë patriotësh po e presin me ankth, ndërsa në sfond qëndron dukshëm një mjet tjetër transporti, një pajton elegant. Teksa Hakiu, karrocieri, nget kuajt, Ismaili na tregohet brenda karrocës, e cila është dhe skena më e përsëritur e filmit,

nën kërcitjet e trokut, duke u shkundur nga rrugët famëkeqe të Shqipërisë, me peizazhin që i shket në sfond, tej dritares. Karvani i tij përparon mes peripecive, mes takimesh herë të ngrohta e herë konfliktuale me turq dashakeqë e shqiptarë të paditur, por që në fund dorëzohen ose e pranojnë udhëtimin drejt destinacionit të pashmangshëm. Diku ata i zë edhe një shtrëngatë e karroca prej zotërinjsh mbetet në baltë. E atëherë Ismaili, sikurse edhe shoqëruesit, ngjitet mbi kalë e njësoj si luftëtarët që e shoqërojnë, hedh mbi supe gunën dhe nuk ndalet. Pak para mbërritjes në Vlorë i duhet të bëjë dhe një kapërcim të fundit, nëpër një lumë, mbi një tjetër mjet transporti, këtë herë një trap druri. Ai, më në fund, arrin në destinacion dhe e përmbush misionin e tij, ngre flamurin dhe shpall pavarësinë. Por dhe më pas nuk gjen prehje, regjisori na tregon se si përmes efektit zanor të trokitjeve të alfabetit mors në sfond, lajmi shpërndahet nëpër botë.

Në përshkrimin e mësipërm del në pah dhe tipari tjetër i Ismailit, ai i *misionarit*. Ai ishte një udhëtar deri në fund, madje ndërroi jetë gjatë një prej udhëtimeve të tij. Ai nuk udhëtonte për qejf por sepse kishte një mision: të siguronte mbështetje për shtetin e porsalindur shqiptar.

Pra në përgjigje të pyetjes se kush është Ismail Qemali për ne, mund të themi që ai është kumbari, babai shpirtëror i shqiptarëve, në lëvizje të pareshtur, në kalvar, deri në përmbushjen e misionit historik të pavarësimit të plotë të Shqipërisë.



Figura 32. Rugëtimi i pavarësisë (nga e majta në të djathtë; nga lart-poshtë) pajtoni në lëvizje si skenë kryesore dhe mjetet e ndryshme të transportit. Itinerari fillon me lajmin e mbërritjes së Ismail Qemalit, zbarkimin në Durrës, ecjen nëpër Shqipërinë e jugut deri në Vlorë dhe shpërhapjen e mëtejshme të lajmit të shpalljes së pavarësisë nëpër botë. (Nëntori i Dytë / YouTube)



Kujtesa si zëvendësuese e pritshmërisë

Pasi nxorëm disa tipare të simulakrës në krah të kryeministrit shqiptar, mund të parashtrijmë pyetjet e radhës. Mos vallë udhëheqësi i sotëm që drejton vendin në ditët e pandemisë do të na thotë diçka me atë fotografi? Mos po i pretendon ai tiparet mësipërme edhe për veten e tij? Mos po na drejtohet si të ishte babai i shqiptarëve? Të jetë pandemia kalvari i tij? E nëse po, si do jetë fundi?

“A e keni parasysh babain kur rreptësohet dhe të shkëlqeshin? E bën sepse të do të kegen? E bën sepse nuk të do si dritën e syve?” (Rama, 2020)

Kryeministri i sotëm e ka veshur petkun e prindit pasi, drejtpërdrejt e pa nënkuptime, ai e quan veten baba, që në këtë rast po qorton disa nga fëmijët e tij. Kanë kaluar disa javë që nga shfaqja e rasteve të para me Koronavirusin e ri e shumë prej tyre, mesa duket, janë treguar të papërgjegjshëm. Në krah të tij qëndron edhe babai i shpirtëror, i pranuar prej kohësh nga fëmijët, pra nga shqiptarët. Por, a do të pranojnë ata që t’ia kalojnë këtë rol të pretenduar, drejtuesit të sotëm? Aq më tepër në këto kohë kur ideja e kombit ka humbur mjaft nga ngarkesat e hershme romantike dhe është gjithmonë e më tepër, haptas, një marrëdhënie interesash.

Kryeministri Rama qëndron përballë shqiptarëve, i vetëm. Kamera e vendosur nën të e bën të duket

dhe më imponues. Ai e mbulon plotësisht boshtin vertikal të imazhit, të ashtuquajturën hapësirë e soditjes (contemplation), e bërë për t'u parë sa më gjatë e për ta vënë shikuesin në mendime (Arnheim, 1988). Arhnehim-i na shpjegon se ne jemi qendra e universit tonë, dhe përmes saj njihemi me botën. Kur shohim një vepër arti, një skulpturë apo tablo, ne lëshojmë vektorë drejt saj. Procesi përsëritet dhe në drejtimin e kundërt. Edhe vepra e artistit lëshon mbrapsht vektorë drejt nesh. Te Skënderbeu, te Selvia, te Sahati, te Skytower, janë termat e zakonshëm me anë të të cilave orientohemi edhe nëpër hapësirat e qytetit, duke zgjedhur elementet më mbizotërues që lëshojnë vektorët më të fuqishëm e më të shumtë drejt nesh.

Ky mekanizëm i perceptimit vihet në lëvizje edhe këtu. Dinamika e ndërveprimit ndodh më së shumti mes nesh si marrës dhe folësit si dërgues dhe mbizotërues i imazhit. Për më tepër, figura e kryeministrit është ballore dhe e padeformuar, kështu vektorët e ndërsjelltë vërshojnë pingul me ekranin duke e shkëputur plotësisht folësin nga elementet e tjerë në sfond. Por dhe ish kryeministri është aty, në të djathtë e dërguesit, pasi fotografia e tij është mjaft e madhe për të mos rënë në sy dhe gjithashtu e zezë përmbi murin e bardhë. Vendosija e saj ka një veçanti, pasi, mbase qëllimisht ose prej ndonjë rastësie fatlume, ajo qëndron në pozicion të pjerrët. Ismaili nuk sheh drejt nesh (Fig. 33). Ai nuk ndërton një marrëdhënie të ndërsjelltë shkëmbimi vektorësh me shikuesin, por duke i kanalizuar ato përmes figurës

qendrore të kryeministrit në fuqi. Ismaili duket sikur po i pëshpërit diçka në vesh, sikur po e këshillon, a thua se po ia kalon pasardhësit vetitë atërore. E vetnja mënyrë për të mësuar mesazhin e plakut të Vlorës është përmes vektorit qendror, përmes fjalëve dhe figurës së udhëheqësit bashkëkohor.

Mbase Ismaili po i tregon atij dhe për kalvarin e pavarësisë. Në fakt pandemia i ka tiparet e një udhëtimit të mundimshëm me fund të panjohur dhe, mesa duket, edhe shqiptarët si ballkanas të mirë, parapëlqejnë strukturimin e historisë së tyre sipas golgotave. Rrugëtimi i mundimshëm për shpalljen e pavarësisë ishte kalvari i Ismail Qemalit, që u përmbyll me sukses, megjithëse jo pa pasoja. Koronavirusi i ri, me sa duket, mund të jetë golgota e radhës, fundin e së cilës ende nuk e dimë:

“Kur do të mbarojë kjo? Po pse, kush e di këtë që ta di unë? Por ama di me siguri një gjë, po vazhduam kështu, do ta kalojmë pa qindra e mijëra viktima e do t'i rihapim pjesë-pjesë rrugët e jetës normale” (Rama, 2020)

Sipas fjalës së kryeministrit, ky mund të jetë edhe fundi i ekzistencës tonë. Nëse do jemi të papërgjegjshëm mund të kemi me *qindra e mijëra të vdekur* e mund të bëhemi

8 Aporia është shprehje dyshimi, të vërtetë apo të stisur, ose pasigurie me qëllim krijimin e efektit retorik. Përkufizimi fjalë për fjalë i termit marrë nga greqishtja e lashtë vjen nga: a-poros: i pakalueshëm. (Merriam_Webster, n.d.)



Figura 33. Boshti i soditjes (a) që kalon në mesin e kryeministrit të sotëm dhe vendosja e kryeministrit të dikurshëm lehtësisht i kthyer (b) nga folësi, gjatë fjalimit të 28 marsit, Rezistencë për Ekzistencë. (Faqja facebook e Edi Ramës)

gazi i botës. Teksa jetojmë të tashmen e pandemisë, fjalët e tij sugjerojnë mundësinë e një fundi pa krye, diçka krejt e padëgjuar për një politikan. Por fjalët e tij, mesa duket, janë *apori*⁸, pasi atij i vjen menjëherë në ndihmë, përsëri, paraardhësi në kornizë, udhëtari me mision, udhëheqësi i kalvarit të mundimshëm të pavarësisë. Sipas Ricoeur⁹, ne jetojmë të tashmen duke shkuar drejt së ardhmes, mes kujtesës dhe pritshmërive (Ricoeur, 1984). Ato nuk janë të izoluar por në ndërveprim me njëra-tjetrën. E në mungesë të pritshmërive, hapësira e tyre plotësohet nga kujtimet. Ismail Qemali, udhëheqësi i dikurshëm, i kujton e na kujton se si i patëm kapërcyer edhe pengesat e kaluara.

⁹ Ricoeur në këtë pjesë të librit të tij zbërthen përvojën e kohës sipas Shën Agustinit.



Figura 34. Kthimi në zyrë dhe rishfaqja e automatizmave gjatë bashkëbisedimit të 21 prillit. (Faqja facebook e Edi Ramës)

Pra, në ditët më të vështira të krizës, udhëheqësi i shkuar qëndron në krah të të sotmit. Roli i tij është thelbësor. Të pasigurt për të ardhmen, falë pranisë së tij prindërore, na vjen në ndihmë e shkuara, kalvari i pavarësisë, madje dhe 28 mijë dëshmorët e Luftës nacional-çlirimtare (Rama, 2020). Kështu, kryeministri, në pamundësi për të ndalur ecjen e kohës drejt së ardhmes së panjohur, të paktën mund të na ndalojë ne, të na mbyllë, izolojë. Sfondi i tij flet përmes së djeshmes së njohur në pritje të çlirimit të së nersërme, pra na thotë të *rezistojmë për të ekzistuar*.

Më datë 21 prill, rreth dyzet ditë nga fillimi i epidemisë së Koronavirusit të ri, kryeministri shqiptar rikthehet përsëri në zyrën e tij të zakonshme të punës, dukshëm më i qetë dhe i qeshur (Fig. 34). Epidemia është,

më në fund, nën kontroll. Me kamerën në lëvizje, qëllimisht ai na drejton, madje duke marrë një qëndrim të parehatshëm, nga sfondi shumëgjyresh i hapësirës së dizenuar nga ai vetë, i njëjti i fjalimit të Vitit të Ri e që na mungonte qysh prej ditëve të para të pandemisë. Këtë herë Ismaili qëndron i fshehur në anën e padukshme të dhomës. Udhëheqësi i sotëm shfaqet përsëri i çliruar nga pesha e paraardhësit, edhe një herë plotësisht *autentik*¹⁰, si dikush që jo vetëm ka pushtetin por edhe që i del në krye vështirësive, i vetëm.

*10 Origjina e termit autentik vjen nga greqishtja e lashtë *authenthikos*: që do të thotë origjinal, i vërtetë, kryesor; *autentes*: dikush që vepron me autoritetin e tij; *autos+bentes*: vetë-bërës (etymonline, n.d.)*

Albin Kurti

Një hapësirë e mbushur me dritë, mbuluar nga tavane me ulje e ngritje që, mesa duket, më shumë se nga arkitekti janë diktuar nga tubacionet e ajrit të projektuara nga inxhinierë mekanikë (Fig. 35). Nëpër tavanet, me shumë gjasa prej gipsi, shohim të shpërndarë pa ndonjë logjikë mirëfilli estetike, ndriçues teknikë. Një parket, që nga pamja nuk duket as i lirë e as i shtrenjë. Në sfond divanë të zinj, gjithashtu krejt të zakonshëm. Në një kënd shohim dy flamuj dhe një imazh të shfokusuar të kopjes së *Deklaratës së Pavarësisë* së vendit¹¹, që na sugjeron se është këndi më i rëndësishmëm i hapësirës e që me gjasë përdoret për

¹¹ Originali rubet nga Kuvendi i Kosovës (Dita, 2014)

cerimonialë ose deklarata për shtyp. Me datë 16 mars 2020, kryeministri i Kosovës, i sapoardhur në pushtet, ka zgjedhur të na drejtohet nga një hapësirë krejt normale, e papritur dhe përsëri, me shumë mundësi, e mirëmenduar.

Thyerja e strukturës

Gjatë fjalës së tij Albin Kurti u tregon qytetarëve të Kosovës se çfarë ka bërë. Ai ka mbyllur deri edhe kufijtë mes qyteteve. I këshillon qytetarët të mbajnë zakonet e mira siç është larja e duarve por të shmangin rrokjen e tyre. Po humbni hapësirë por po fitoni kohë, thotë ai, pra mund të lexoni ndonjë libër që e keni lënë më parë mënjanë. Ai po përshkruan një situatë të jashtëzakonshme, të rëndë, pasi i thotë ndjekësve që i



Figura 35. Kryeministri i Kosovës gjatë fjalimit të 16 marsit pas shfaqjes në vend të Koronavirusit të ri, titulluar *Në shtëpinë tuaj me duar të pastra*. (Faqja facebook e Albin Kurtit)

ka kyçyr, se duhet të heqin dorë nga zakone të lashta sa vetë qytetërimi por e bën këtë a thua se po përshkruan një situatë të përditshme. Ai na jep përshtypjen se ka nisur ditën normale të punës. Është bërë gati në kohë, pa u nxituar, është larë, është rruar e krehur, ka veshur kostumin e zyrtarit shtetëror dhe është nisur për në zyrë. Më pas, siç duket, e kanë ndalur, e kemi ndalur, të shqetësuar nga Koronavirusi i ri, vdekjeprurës, që ka tronditur botën, pikërisht te paradhoma e zyrës së tij. Ai nuk duket i besdisur. I qetë, është kthyer nga ne dhe duke na vështruar në sy, me fjalë të thjeshta, të cilat i shqipton me kujdes, na sqaron:

“Është situatë e përkohshme dhe do t’i kthehem normalitetit” (Kurti, 2020)

Fjalët tij përçojnë të njëjtin normalitet që gjetëm te hapësira dhe sfondi i tij, a thua se kemi të bëjmë me një moment përditshmërie. Por shpejt kuptojmë që normaliteti i atij çasti është i ndryshëm nga normaliteti i një dite më parë.

“Ne këtu në qeveri vazhdojmë punën me të njëjtën energji dhe vullnet por me staf të reduktuar” (Kurti, 2020)

Sinkronia fjalë-hapësirë vazhdon të jetë e njëjta pasi dhoma pas folësit është e zbrazur, zhytur në qetësi të plotë. Heshtja dhe zbrazëtia bëhen edhe më therëse duke qenë se mjedisi i zgjedhur nuk duket si zyra personale e punës që do ta përligjte vetminë e udhëheqësit. Pas tij kemi një holl që normalisht duhet të ishte i mbushur me njerëz, me zëra e me lëvizje, me nëpunës që shkojnë sa andej e këndeje, me vizitorë të ulur nëpër divanë, me sytë ngulur nëpër smartfonë, duke folur me njëri-tjetrin ose me veten të emocionuar nga takimi që do kenë me njeriun më të pushtetshëm të vendit. Por aty s’ka njeri, mungesa e çdo gjëje të gjallë në një mjedis që duhet të gëlonte, na zbulon se gjatë përditshmërisë së re do të na duhet të bashkëjetojmë me Koronavirusin e ri. Ky i fundit është aq i rrezikshëm sa të zbrazë edhe qendrën e pushtetit.

Kryeministri i Kosovës po përpiqet ta ekzorcizojë rrezikun e pandemisë duke deheroizuar (Lefebvre, 1991) kundërpërgjigjen e tij. Këtë e bën me disa mjete




Figura 36. Boshti kryesor i hapësirës (b) dhe mospërputhja vektorit të kryeministrit (a) gjatë fjalimit të 16 marsit; kopja e Deklaratës së Pavarësisë në fund të perspektivës (pra të boshtit b) e përdorur gjatë takimit me ambasadorin e Shqipërisë në ditën e marrjes së pushtetit (Top Channel/YouTube)

shprehëse. Ai mund të kishte dalë edhe te sfondi me flamuj, pak metra më andej, të shtonte simulakra deklamuese dhe të fliste për luftë, por jo. Përkundrazi ka zgjedhur të mos flasë nga fundi i boshtit kryesor të hollit ku po qëndron, përpara Deklaratës së Pavarësisë. Mbase, po ta bënte, mesazhi i tij dhe ai vetë do bëhej më solemn, por gjithashtu edhe kundërshtari, shkaktari i pandemisë do të dukej më kërcënues. Si rezultat i vendosjes së tij në skaj të hapësirës, vektori i ndërsjelltë që ai ndërton me spektatorët e fjalimit, përplaset diagonalisht me boshtin kryesor të hollit (Fig. 36), dhe përfundon diku te dritaret pas divanëve të zinj, duke thyer strukturën, duke hequr çdo nuancë fataliteti apo paracaktueshmërie nga skena.

Hapësirë kalimtare

Një nga efektet e thyerjes së mësipërme të strukturës është përforcimi i karakterit kalimtar të sfondit të drejtuesit të Kosovës. Shikimi ynë fluturon përgjatë

boshtit horizontal të imazhit, nga njëri divan te tjetri, nëpër kthinat e mureve, te flamujt dhe imazhi i varur mbi mur, në kërkim të qendërsive, por pa i gjetur ato. Tiparet tranzitore të sfondit lidhen fort me vetë funksionin tranzitor të mjedisit. Hapësira, siç e shohim, nuk është bërë për të qëndruar gjatë, nuk duket si zyrë apo sallë takimesh. Vendi i zgjedhur është thjesht diçka më shumë se një korridor. Interpretimet për organizimin përballë nesh mund të jenë të shumta, për shembull Doxadis shkruan se korridori është hapësirë pozitive, e hapur, ndërlidhëse dhe në ndryshim (Doxadis, 1963).

Përveç hapësirës, vetë ngjarja e fjalimit është ndërtuar si një takim kalimtar, aq i shpejtë sa nuk kemi kohë as të ulemi. Kujtojmë që kryeministrin e patëm ndërprerë rrugës për në zyrë e ai na drejtohet por shumë shkurt, vetëm dy minuta, pasi i duhet të vazhdojë, përgjegjësitë i ka të shumta dhe koha është e çmuar. Pra, me sa kuptojmë, karakteri kalimtar që i është dhënë skenës së Albin Kurtit, është i rëndësishëm. Në pamundësi për ta provuar veten, pasi e ka marrë pushtetin vetëm disa javë më parë, ai dëshiron të paraqitet si udhëheqës i hapur, komunikues, dinamik, fjalëpak dhe punëshumë.

Autenticiteti përsëri

Forma e kryeministrit në mes të imazhit, është e fortë. Silueta e tij e errët, spikat në hapësirën e mbushur me dritë të bardhë. Edhe ai e sundon plotësisht boshtin

e soditjes për të cilin folëm pak më lart. Natyrisht, të gjithë udhëheqësit që kemi parë deri tani, janë qëndrorë në fjalimet e tyre, por te dy drejtuesit shqiptarë, kjo bie në sy edhe më shumë. Ata qëndrojnë më pranë objektivave të kamerave, duke e bërë të duket si më të vërtetë, afrimitetin e simuluar me ndjekësit.

Regjisori i fjalimit të datës 16 mars ka përdorur edhe efektin *depth of field*. Figura e folësit është ekstremisht e qartë ndërsa sfondi i mjegullt dhe i largët. Kjo lojë pamore imiton vështrimin tonë normal. Ndërsa ne jemi duke folur me dikë, shikimi ynë është selektiv. Ne s'mund ta shohim njëkohësisht folësin dhe sfondin. Pra edhe këtë herë gjendemi në një nga ato situatat *verite*, ku:

“duket sikur nuk jemi aty” barazohet me “duket sikur jemi aty” (Baudrillard, 1994).

Mesa vëmë re, të dy udhëheqësit shqiptarë përpiqen të jenë autentikë. Thyejnë panoptikonin që i ndan nga ndjekësit duke i ftuar këta të fundit në realitetin e tyre, a thua se ata janë aty me këta. Të kuptohemi, të jesh autentik dhe të jesh i sinqertë janë dy gjëra të ndryshme dhe në kulturën perëndimore, autenticiteti e ka tejkalar rëndësinë e sinqeritetit, si tipari më i lartë i karakterit prej shekujsh (Cobb, 2014). Autenticiteti i kryeministrit të Kosovës është i ndryshëm nga paternalizmi i kryeministrit të Shqipërisë, më i

ngjashëm me atë të kancelares gjermane, pasi edhe ai zgjedh të jetë një figurë familjare, por më pak dominuese e më shumë komunikuese.

Në fund duhet të jemi të vetëdijshëm që edhe ky fjalim, si dhe fjalët e udhëheqësve të tjerë, është ndërtuar për të kapërcyer nëpër shkretëtirën e reales pra duhet të bëjmë kujdes para se ta përqafojmë pa kushte dhe pa kërkuar për mesazhe të nënkuptuara. Jo më kot fjalimi i Albin Kurtit titullohet:

*“Në shtëpinë tuaj me duar të pastra”
(Kurti, 2020)*

Shprehja mund të interpretohet si këshillë për t’u kujdesur për higjienën por dhe si një mënyrë për t’u vetëftuar në realitetin e familjes tonë. Hegel shkruan se *“Familjarja nuk kuptohet plotësisht pasi është familjare”* dhe Le Febvre, na e zbërthen këtë shprehje si më poshtë:

*“Familjariteti, ajo që është familjare,
e fsheh qenien njerëzore dhe e bën të
vështirë për t’u kuptuar duke i dhënë një
maskë të njohur për ne” (Lefebvre, 1991)*

Sfondi i fjalimit të Albin Kurtit flet për një drejtues që po përpiqet të thyejë strukturat dhe të shfaqet si udhëheqës racional, pra modern. Ai e ka zhveshur veten nga gjuha, e folur dhe pamore, e ngarkuar me

metafora dhe simbole, tipike e shoqërisë që po përpiqet të drejtojë. Shumë shpejt, vetëm pak ditë pas atij fjalimi, autoriteti i tij do të vihet në diskutim dhe ai do të detyrohet të lërë postin. Vetëm koha do ta tregojë nëse ai vërtetë dëshiron të thyejë strukturat ekzistuese, siç bën me skenën e fjalimit të tij, apo thjesht është, momentalisht, i paaftë për t'u bërë pjesë e tyre.

Epilog

Në mbyllje të këtij shkrimi, me siguri, për çdo përgjigje të dhënë, do të lindin edhe më shumë pyetje. Në ditët e sotme kështu siç jemi të *qullur nga masazhet*¹² *mediatike*, gjetja e të vërtetave është më e vështirë se kurrë. Kështu, një anekdotë e vjetër sovjetike, nga ato të radio Jerevanit thotë:

A është e vërtetë që falë arritjeve të teknologjisë Sovjetike, së shpejti do të mund të porosisim ushqimin nga telefoni? Po, burimet tona na thonë që është e vërtetë. Të njëjtat burime thonë që ushqimi i porositur do të dorëzohet me televizor.

¹² Baudrillard përdor qëllimisht termin *masazh dhe jo mesazh*

Popujt që i kanë jetuar regjimet totalitare i njohin mirë vetitë e propagandës, ata e kujtojnë se si sukseset e regjimit shtoheshin e lajmëroheshin me zë të lartë ndërsa në përditshmërinë e tyre pakësohej ushqimi dhe zgjateshin radhat. Falë njohjes së këtyre përvojave, lindin dyshime mbi mënyrën e të reaguarit. Çfarë të bëjmë, të mbyllim veshët kur autoriteti flet, pasi medoemos gënjen?

Vërtet, shpesh narrativat e pushtetit janë mashtruese por ndonjëherë janë edhe të nevojshme. Mjafton të rikujtojmë fjalimin e Stalinit, të 3 korrikut 1941, disa ditë pas operacionit të rrufeshëm gjerman *Barbarossa*, ku i tregonte popullit sovjetik për trimërinë e ushtrisë së kuqe (Stalin, 1941). Nuk mund të mohojmë se në atë moment historik, në prag të betejës vendimtare

me nazizmin, fjala e tij ishte ngushëlluese për popullin e tij, pavarësisht karakterit gjakatar të diktatorit. E ndërsa është shumë e rëndësishme të dimë ta vështrojmë pushtetin përtej maskës, përpara se t'i paragjykojmë, nuk duhet të harrojmë që maskat janë pjesë e pandashme e natyrës njerëzore, apo siç shkruan Lefebvre:

“Maskat ngjiten mbi fytyrat tona, mbi lëkurën tonë, mishi dhe gjaku bëhen maskë” (Lefebvre, 1991)

Ngujimi nëpër realitetet tona nuk është zgjidhje. Siç e pamë dhe më lart, autoriteti gjithmonë e më tepër po ia del të depërtojë në realitetin tonë, e sikur kjo ndërthurje të mos ndodhë në mjedisin virtual ai, herët a vonë, do të na trokasë në derë. Pra marrëdhënia jonë me të është e pashmangshme dhe për këtë arsye është e nevojshme që ta njohim sa më mirë. Ky tekst përpiqet të ndriçojë disa aspekte të kësaj marrëdhënie.

Udhëheqësit botërorë, në ditët e pandemisë, iu drejtuan banorëve të botës, me fjalimet e tyre. Përveç fjalëve, çdo element i hapësirës përreth tyre kishte diçka për të thënë. Në disa raste ato përsërisnin fjalët, ndonjëherë thonin edhe më tepër. Me fjalimet e marsit filloi narrativa e Koronavirusit të ri, skenarët e të cilave projektohen dhe përditësohen edhe nëpër hapësirat e pushtetit. Po aty ku u përgatitën fjalimet e luftës, me siguri po përgatiten edhe fjalimet e fitores.



Figura 37. Ne zgjedhim shkencën dhe jo trillimin, marrë nga një postim i kandidatit për president të ShBA-ve Joe Biden. (Faqja facebook e Joe Biden)

Ato mund të jenë të vërteta, pjesërisht të vërteta ose të gënjeshtra.

“*Science over fiction*”, do të shkruajë John Biden në faqen e tij facebook (Fig. 37) duke u radhitur mes atyre që përdorin logjikën dhe jo retorikën në politikë, sipas tij, ndryshe nga rivali i tij president. Me këtë shprehje ai dëshiron t’i thotë amerikanëve, lërimi trillimet e më dëgjoni mua, ekskluzivitetin e së vërtetës e kam unë pasi flas me argumenta shkencorë dhe jo imagjinarë. Këtë kontrast të ngjashëm e pamë edhe te fjalimet e Koronavirusit të ri, pasi disa prej folësve i përdornin

dendur metaforat dhe u drejtoheshin emocioneve tona, nganjëherë më primitiveve, ndërsa të tjerë mundoheshin t'i flisnin arsyes. Në të shkuarën, Platoni e shpallte veten përçmues të poezisë (Plato, 1997). Ai e quante atë mashtruese, retorikë, e megjithatë vetë shprehej *përmes dialogjesh "dramatike" me tipare po aq poetike* (Griswold, 2020).

Në fund të fundit arsyeja fle bashkë me emocionet në trupin tonë, t'i ndash është e pamundur. Mbase edhe ata që shpallen partizanë të arsyes po përpiqen gjithashtu të hyjnë në realitetin tonë, por nga një derë tjetër. Ndarja e trillimit nga realiteti është ndërmarrje e vështirë pasi të dyja i nënshtrohen strukturës organizuese të diktuar nga narrativa. Historia dhe tregimet kallzohen në të njëjtën mënyrë, po njësoj siç tregojmë ndodhitë në përdishmërinë tonë (Ricoeur, 1984). Ne mërzitemi edhe kur sezoni i fundit i *Game of Thrones* nuk e ka koherencën e duhur edhe nëse nuk arrijmë t'i japim kuptim jetës tonë. Të paktën vetëdija për vështirësinë e shkëputjes së të vërtetës nga trillimi, edhe në fjalimet e analizuara në këtë shkrim, mund të na ndihmojë të jemi më të matur, të dyshojmë përpara se të besojmë që të mos bëhemi thjesht sipërfaqe përthithëse dhe ripërthithëse informacioni (Baudrillard, 1994).

22 prill 2020, *The Independent* do të njoftonte me shqetësim, si *breaking news*, pra si lajm i jashtëzakonshëm, se loja e realitetit virtual *Call of Duty* kishte ndalur së

funksionuari në të gjithë botën (O'Connell, 2020). Mesa duket, pandemia e Koronavirusit të ri ato ditë filloi të humbte privilegjin e të qenit e veçantë, për t'u kthyer gradualisht, edhe ajo, në njërin prej realiteteve të realitetit tonë.

Bibliografi

- Ancic, I., 2017. Belgrade, The 1961 Non-Aligned Conference, s.l.: s.n.
- Arnheim, R., 1954. *Art and Visual Perception*. 1974 ed. Berkley and Los Angeles: University of California Press.
- Arnheim, R., 1974. *Entropy and Art: An Essay on Disorder and Order*. Los Angeles: University of California Press.
- Arnheim, R., 1988. *The Power of the Center*. Berkley and Los Angeles: University of California Press.
- Association, T.W.H.H., n.d. www.whitehousehistory.org. [Online]
Available at: <https://www.whitehousehistory.org/questions/what-is-the-resolute-desk-and-where-did-it-come-from>
[Accessed May 2020].
- Baudrillard, J., 1983. *The Ecstasy of Communication*. In: H. Foster, ed. *The Anti-Aesthetic*. Washington: Bay Press, pp. 126-134.
- Baudrillard, J., 1994. *Simulacra and Simulation*. 1st edition ed. Michigan: University of Michigan Press.
- Baudrillard, J., 1994. *Simulacra and Simulation*. 1st edition ed. Michigan: University of Michigan Press.
- Belgrade, C. H. P. I. o., 2013. *New Royal Palace, Belgrade*: Cultural Heritage Preservation Institute of Belgrade.

- Benjamin, W., 1969. The Work of Art in the Age of Mechanical Reproduction. In: H. Arendt, ed. *Illuminations: Essays and Reflections*. New York: Schocken Books.
- Breton, A., 1924. *Manifesto of Surrealism*. s.l.:s.n.
- Britannica, T. E. o. E., 2020. Reichstag. s.l.:Encyclopædia Britannica, inc..
- Churchill, W., 1940. winstonchurchill.org. [Online]
Available at: <https://winstonchurchill.org/resources/speeches/1940-the-finest-hour/their-finest-hour/>
[Accessed May 2020].
- Cobb, R., 2014. Introduction: The Artifice of Authenticity in the Age of Digital Reproduction . In: R. Cobb, ed. *The Paradox of Authenticity in a Globalized World*. New York: Palgrave Macmillan, pp. 1-9.
- Colovic, I., 2002. *The Politics of Symbol in Serbia: Essays in Political Anthropology*. London: Hurst & Company.
- CrisisGroup, 2009. *Nurturing Instability: Lebanon's Palestinian Refugee Camps*. Beirut/Brussels: Crisis Group.
- Dita, G., 2014. *Ku ndodhet Deklarata e Pavarësisë së Kosovës?*, Tiranë: Publikime Shqiptare.
- Doxadis, C. A., 1963. *Architecture in Transition*. New York: Oxford University Press.
- etymonline, n.d. www.etymonline.com. [Online]

- Available at: <https://www.etymonline.com/word/authentic> [Accessed May 2020].
- Goode, J. M., 2010. Four Salutes to the Nation: the equestrian statues of general andrew jackson. White House History , Spring.
- Government, T. P. a. I. O. o. t. F., 2020. Virtual tour of the Chancellery. [Online] Available at: <https://www.bundeskanzlerinde/bkin-en/chancellery/virtual-tour> [Accessed May 2020].
- Griswold, C. L., 2020. Plato on Rhetoric and Poetry. s.l.:The Stanford Encyclopedia of Philosophy.
- Haberman, M., 2017. A Homebody Finds the Ultimate Home Office. New York Times, 26 January.p. 14.
- John B. Allcock, J. R. L., 2020. Serbia. s.l.:Encyclopædia Britannica, inc.
- John R. Lampe, T. M. P., 2020. Serbia: Life in the Ottoman period. s.l.:Encyclopædia Britannica, inc..
- Jung, C. G., 1981. The Archetypes and the Collective Unconscious. 2nd ed. London: ROUTLEDGE.
- Kurti, A., 2020. Nw shtwpinw tuaj me duar tw pastra. Pristina: s.n.
- Lefebvre, H., 1991. Critique of Everyday Life. London - New york: Verso.
- Merkel, A., 2020. https://www.general-anzeiger-bonn.de/ga-english/news/angela-merkel-s-speech-about-the-corona-virus-in-full_aid-49639811. [Online] Available at: https://www.general-anzeiger-bonn.de/ga-english/news/angela-merkel-s-speech-about-the-corona-virus-in-full_aid-49639811 [Accessed May 2020].
- Merriam_Webster, n.d. Merriam_Webster.com. [Online] Available at: <https://www.merriam-webster.com/dictionary/aporia> [Accessed May 2020].
- Nëntori i dytë. 1982. [Film] Directed by Viktor Gjika. Albania: Kinostudio Shqipëria e Re.
- O'Connell, O., 2020. Call of Duty down: Game stops working for users around the world, New York: s.n.
- Pantone, 2020. store.pantone.com. [Online] Available at: <https://store.pantone.com/uk/en/color-of-the-year> [Accessed 11 May 2020].
- Pantone, n.d. store.pantone.com. [Online] Available at: <https://store.pantone.com/uk/en/color-of-the-year> [Accessed 11 May 2020].

- Pauls, E. P., 2019. Trail of Tears. s.l.:Encyclopædia Britannica, inc..
- Plato, 1997. Plato: Complete Works. In: J. M. Cooper, ed. Republic. Indianapolis: Hackett Publishing Company, Inc.
- Qëndro, G., 2011. Gjuha pamore: Pjesa e parë. botime afrojdit ed. Tirana: s.n.
- Rama, E., 2020. Rezistencë për ekzistencë. Komunikimi publik i Kryeministrit lidhur me situatën e pandemisë së Covid-19. Tirana: s.n.
- Ricoeur, P., 1984. Time and Narrative. Chicago & London: The University of Chicago Press.
- Ricoeur, P., 1984. Time and Narrative. Chicago & London: University of Chicago Press.
- Rijke, A. & Teeffelen, T. v., 2014. To Exist Is to Resist: Sumud, Heroism, and the Everyday. s.l.:s.n.
- RPSSH, A. e. S. e., 1985. Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tiranë: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja e Re.
- Rrethi i Kujteses. 1987. [Film] Directed by Esat Musliu. Albania: Kinostudio Shqiperia e Re.
- Stalin, J. V., 1941. www.tracesofwar.com. [Online]
Available at: <https://www.tracesofwar.com/articles/4628/Radio-speech-by-Stalin-03-07-1941.htm>
[Accessed May 2020].
- Stojanovic, S., 2009. Varieties of Stalinism in Light of the Yugoslav Case . In: V. TISMANEANU, ed. Stalinism Revisited: The Establishment of Communist Regimes in East-Central Europe. New York: Central European University Press, pp. 387-400.
- Thompson, D., 2008. Railway Noise and Vibration: Mechanisms, Modelling and Means of Control. s.l.:Elsevier.
- Trump, D., 2020. www.rev.com. [Online]
Available at: <https://www.rev.com/blog/transcripts/donald-trump-speech-transcript-on-coronavirus-ban-on-europe-travel>
[Accessed May 2020].
- Vitruvius, M., n.d. De Architectura, Book IV. s.l.:s.n.
- Vogel, K. P., 2018. Trump Leaves His Mark on a Presidential Keepsake. Washington: The New York Times.
- Vucic, A., 2020. CGTN. [Online]
Available at: <https://www.youtube.com/watch?v=P42OrsA045M>
[Accessed May 2020].

Botuar nga POLIS_PRESS, Tiranë, Janar 2021.